



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Bankë - Financë”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Sherif BUNDO

Dr. Andromahi KUFO

Maj / 2020

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Universiteti “Aleksadër Moisiu”, Durrës (UAMD) ka filluar aktivitetin si institucion publik i arsimit të lartë bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 801, datë 20.12.2005. UAMD është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit VBA Nr. 10, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2021.

Sipas Statutit dhe Rregullores aktualisht UAMD është i organizuar në 6 Fakultete dhe 23 Departamente. Fakultetet janë si më poshtë:

1. Fakulteti i Biznesit;
2. Fakulteti i Edukimit;
3. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
4. Fakulteti i Studimeve Profesionale;
5. Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP);
6. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;

Fakulteti i Biznesit përgjegjës për programin e studimit përbëhet nga 5 Departamente si më poshtë:

1. Departamenti i Turizmit;
2. Departamenti i Shkencave Ekonomike;
3. Departamenti i Menaxhimit;
4. Departamenti i Marketingut;
5. Departamenti Financë – Kontabilitet;

Programi i studimit Master Profesional në “Bankë-Financë” ofrohet nga, Fakulteti i Biznesit, Departamenti Financë-Kontabilitet i hapur në vitin akademik 2009-2010 me VKM Nr. 1161, date. 25.11.2009. Ky program studimi rrjedh nga programi MP në Ekonomi Biznes me profile: a. Financë Bankë; b. Drejtim i SME- ve, licensuar me VKM Nr. 1161, datë 25.11.2009, i cili është riorganizuar në: MP “Bankë – Financë”, me Vendim Senati Nr. 106 datë, 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresë Nr. 7243/1, datë 22.08.2018. Ky program përmban gjithsej 60 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 1 vit akademik.

Raporti i Vlerësimit nga Ekspertët e Jashtëm, shqyrton ecurinë e programit përgjatë viteve akademike 2013 – 2014 e deri në vitin aktual akademik 2019-2020. Ky raport përshkruan analizën mbi treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përmbushjes së standarteve sipas kërkesave të cilësisë së ASCAL dhe nëse programi është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të UAMD.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, date 11.09.2018 për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Bankë-Financë”.


Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë, në VKM nr. 109 për orgnaizmin e ASCAL, dhe në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ASCAL ka përzgjedhur me Urdhër nr. 84, dt. 16.10.2019, dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga institucioni për akreditimin e programit Master Profesional në “Bankë-Financë”. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof.Dr Sherif Bundo dhe Dr Andromahi Kufo. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.

Pas komunikimit nga ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët studiuuan dhe vlerësuan dosjen e programit, raportin e vetevlerësimit dhe gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, ngarkuar në sistem. Ekspertët mbas njohjes dhe vlerësimit të gjithë dokumentacionit, bënë përgatitjet e nevojshme, përpiluan pyetjet apo evidentuan paqartësitë e tyre, dhe u përcaktuan nëpërmjet ASCAL-it datat e vizitave në institucion. Si fillim vizita në institucion u fiksua në datat 26 dhe 27 Nëntor 2019, por për shkak të situatës së shkaktuar nga katastrofa natyrore e tërmetit në 26 Nëntor 2019, vizita në institucion u shty në datat 28-29 Janar 2020. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i UAMD u angazhua për t’iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm të vlerësimit. Ekspertët kërkuan edhe dokumenta të tjera shtesë, i cili u bë i disponueshëm në datën 4 Shkurt, 2020.nëpërmjet sistemit AMS.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Profesional “Bankë-Financë”. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.04.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 4/39 Prot, datë 15.04.2020. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës përcjell nëpërmjet sistemit më datë 28.04.2020, komentet në lidhje me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme pas pandemisë së COVID-19. Komunikimi me UAMD. është berë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132 datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91 date 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190 datë 19.03.2020.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:




1. Në raportin e GVJ shkruhet: “Përmbajtja e programit mësimor me lëndë të fushës si: Drejtimi Financiar, Menaxhimi i Riskut, Kontabiliteti Financiar, e garantojnë dhe i përgjigjen profesionit të fushës së Bankë-Financë.”, standarti I.3, kriteri 3.

“Struktura e programit me të gjitha elementët që e shoqërojnë janë në përputhje me profilin e programit. Disa përjashtime që janë përmendur edhe te standarti II.1, kriteri 4 lidhur me përputhjen e disa lëndëve me profilin. Në lidhje me programet e tjera ndërkombëtare GVJ mendon se përafrimi ndërkombëtar duhet të jetë në fillim gjeografik rajonal në Ballkan dhe Europë, gjë të cilën nuk e konfirmon në këtë rast”, standarti II.4, kriteri 4. “Sipas dokumentacionit të ofruar nga Institucioni (*evidenca 68*) programe të shkollave Ekonomike/të Biznesit nga India, SHBA, Zelanda e Re, Australia dhe Sllovenia janë marrë parasysh për të krahasuar programin e studimit në “Bankë- Financë”. Programi është ristrukturuar në vitin 2018 dhe gjatë takimeve me dekanin dhe shefin e departamentit mësuam se kurrikula e rishikuar është bazuar në kurrikula të ngjashme të ofruara nga vendet e rajonit dhe BE, por për këtë nuk ka ndonjë evidencë të ngjashme përveç të sipërpërmendurës. GVJ bazuar në verifikimin e tij sa më sipër sugjeron se programi duhet riparë në aspektin e përmbushjes së objektivave të tij dhe, duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal, dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, si në Ballkan dhe BE, për të rritur konkurrueshmërinë e studentëve.”, standarti I.3, kriteri 4.

Institucioni përgjigjet: Ristrukturimi i programit të studimit Master Profesionl Bankë Financë është bërë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 neni 86 (Programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel të paktën 70%). Ndërkohë nga kërkimet në vendet e rajonit na rezulton që Master Profesional në Bankë Financë nuk kemi arritur te gjejmë. Master Shkencor po por profesional jo. Përfundimisht, për këtë koment, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

Arsyetimi: GVJ gjykon se një kërkim tregu më i kompletuar është i nevojshëm në këtë rast.

2. Në raportin e GVJ shkruhet: “Programi aktual funksionon për 10 vite në treg, por është vërejtur nga dokumentacioni i shqyrtuar se ka një ulje të numrit të studentëve për 4 vitet e fundit. Nga intervistimi me përfaqësues të institucionit kjo shpjegohet se ka ardhur si pasojë e hapjes së programit të studimit master shkencor në Financë, program që rezulton më i preferuar dhe i parapëlqyer prej studentëve. Për këtë arsye ndoshta duhet riparë nëse duhet të diferencohet roli i dy programeve në aspektin kurrikular dhe në tregun tek i cili ofrohet.” standarti I.3, kriteri 8.

Institucioni përgjigjet: “Kriteri 8 kërkon: Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar. Programi i ciklit të dytë “Master profesional” Bankë-Financë nuk është hapur përkohësisht sepse funksionimi i tij e bën të nevojshme plotësimin e nevojave në treg për personel të kualifikuar në drejtim të bankierëve dhe financierëve sipas kërkesave të sistemit financiar dhe bankar. Përfundimisht, për këtë pikë, **GVJ bën ndryshime në raport. Tek standarti I.3, kriteri 8 si më poshtë:**

“Programi aktual nuk është hapur përkohësisht. Ky program funksionon për 10 vite në treg dhe plotëson kerkesat e tregut në fushën e Bankë-Financë. GVJ gjithsesi ka vërejtur nga dokumentacioni i parë se ka një ulje të numrit të studentëve rreth 4 viteve të fundit. Nga




intervistimi me përfaqësues të institucionit kjo shpjegohet se ka ardhur si pasojë e hapjes së programit të studimit master shkencor në Financë, program që rezultoi më i preferuar dhe i parapëlqyer prej studentëve.

Për këtë arsye ndoshta duhet riparë nëse duhet të diferencohet roli i dy programeve në aspektin kurrikular dhe në tregun tek i cili ofrohet.”

3. Në raportin e GVJ shkruhet: “Programi i studimit MP në “Bankë-Financë” përfshin module si Menaxhimi i Riskut, Drejtimi financiar i Avancuar apo Amvisim Portofoli, që kanë si qëllim jo vetëm njohjen me teorinë, por aplikimin e tyre në praktikë, si lëndë të avancuara. Gjithsesi duhet nënvizuar se njohuritë e avancuara në fushën e marketingut, sistemit tatimor dhe doganor apo të drejtimit të projekteve janë jashtë kontekstit të fushës Bankë – Financë. Këto lloj lëndësh mund të jenë lëndë me zgjedhje për studentët që ju nevojiten në punësimin e tyre apo kanë dëshirë të zgjerojnë njohuritë në fushat e sipërpermendura. Përfshirja në program e një numri të konsiderueshëm lëndësh të avancuara, i japin programit më shumë pamjen e një programi studimi Master shkencor se sa profesional.” Standarti II.1, kriteri 3. “Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive kryesisht mundësojnë thellimin e njohurive të fushës, si psh Drejtimi Financiar i Avancuar apo Menaxhimi i Riskut. Por në lidhje me përmbajtjen e tyre vërehen prerje të lëndëve, ngjeshje të koncepteve dhe përdorim i të njëjtës literaturë në lëndë të ndryshme, dhe i së njëjtës literaturë me bachelorin në disa raste.” Standarti II.4, kriteri 2. “Nevojat specifike lokale të identifikuara nga institucioni nëpërmjet studimit të tregut janë reflektuar në rishikimin e kurrikulës të vitit 2018. Lëndët “Sistemi tatimor dhe doganor” dhe “Kontabiliteti i Institucioneve Financiare” i përgjigjen më shumë të diplomuarve që kanë qenë të punësuar në këto fusha. Si pasojë edhe nevojat specifike lokale janë pasqyruar në këtë rishikim.” Standarti II.6, kriteri 4.”

Institucioni Përgjigjet: Programi ka vetëm një lëndë profili të avancuar ndërkohë lëndët e përfshira në program nuk janë të avancuara për nivel Master Shkencor. Ndërkohë lëndë si “Sistemi tatimor dhe doganor” janë lëndë me zgjedhje dhe i përshtaten nevojave specifike të tregut.

Përfundimisht, për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

Arsyetimi: GVJ nga takimet me personelin akademik ka konfirmuar se përmbajtja e lëndëve në masterin profesional është më e avancuar se ajo e bachelorit dhe kryesisht e drejtuar nga praktika. Gjithsesi në rishikim të syllabuseve GVJ ka gjetur tema të përsëritura nga programe të ngjashme bachelorit dhe ka vërejtur një numër tematikash shumë të lartë që trajtohen në një master shkencor. GVJ mendon se ka shumë ngjeshje të tematikave për një master profesional.

4. Në raportin e GVJ shkruhet: “Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Forma më e përdorur për këtë ka qenë organizimi i anketave dhe pyetësorëve, të cilët përpilohen në bashkëpunim me zyrën e karrierës dhe të kontrollit të cilësisë. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve (*Rregullorja e NJSBC, neni 6*), si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit (*parashikuar në Rregulloren e Fakulteti të Biznesit, neni 83*). Sipas konstatimit të GVJ rezultatet e pyetësoreve bëheshin të ditura në mbledhje departamentale dhe trajtoheshin me sensitivitet përkundrejt pedagogut




përkatës. Në raste për të cilat është nevojitur trajnim i pedagogëve në lidhje me aftësitë e tyre komunikuese dhe metodikën në auditor, është mundësuar mbështetja përkatëse nga Fakulteti i Edukimit me seminare të ndryshme. Sugjerohet që pyetësoret të kryhen në bazë semestrale në koordinim me NJSBC dhe përfundimet t’ju bëhen të ditura dhe studentëve.” Standarti III.1, kriteri 3.

Institucioni Përgjigjet: Në praktikën e ndjekur në koordinim me NJSBC pyetësorët zhvillohen çdo semestër.

Përfundimisht, për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

Arsyetimi: Ky koment është më tepër për pjesën që rezultatet duhet “t’ju behen të ditura studentëve”.

5. Në raportin e GVJ shkruhet: “Institucioni ka angazhuar staf akademik kryesisht të jashtëm për të plotësuar kërkesat e programit; kriteri 70% e personelit të jetë staf i brendshëm nuk plotësohet. Kjo është e konfirmuar edhe nga shefja e Departamentit. Për sa i përket angazhimit optimal, nga evidencat e dorëzuara pas vizitës, përfshihet angazhimi i stafit vetëm në programin MP, jo në të gjithë programet e Fakultetit. Për rrjedhojë GVJ nuk është në gjendje të përcaktojë nëse stafi ka mbingarkesë dhe nëse kryhet një ndarje optimale e ngarkesës në burimet njerëzore të disponueshme.” Standarti IV.2, kriteri 4.

Institucioni Përgjigjet: Evidenca 25: “Ngarkesa mësimore e departamentit Financë Kontabilitet” ka qenë pjesë e dosjes së dorëzuar fizikisht dhe është ngarkuar në sistemin e ASCAL. Në këtë evidencë pasqyrohet ngarkesa e plotë e Departamentit Financë Kontabilitet në të gjitha programet e studimit nga viti akademik 2013-2014 deri në vitin akademik 2018-2019.

Përfundimisht, për këtë pikë, **GVJ nuk bën ndryshime në raport.**

Arsyetimi: Evidenca 25 përmban ngarkesën totale mësimore të gjithë stafit të Departamentit në të gjithë programet për vitet akademike sic i permendni, jo për programin Bankë-Financë, ndërsa evidenca e dërguar pas vizites përmban ngarkesën e stafit vetëm në programin MP Bankë Financë për 2019-2020, dhe jo në programet e tjera. GVJ ka kërkuar evidencën e ngarkesës së stafit të programit MP Bank Financë, në programin aktual dhe në programet e tjera në një evidencë të vetme që të shikojë vetëm për stafin e programit nese ka mbingarkesë. Këto dy evidenca edhe nëse perdoreshin në kombinim nuk i referohen të njëjtëve vite akademike. Kjo ka qenë arsyeja që GVJ nuk është shprehur. Nese institucioni vendos në dispozicion dokumentin e kërkuar do te mund te shpreheshim saktësisht si psh. “Prof. Nexhipi ka 240 orë mësimore në programin MP Bankë-Financë, dhe XXX orë mësimore në programe të tjera”.

Për sa mësipër GVJ gjykon se vlerësimi i standarteve në final nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Bankë – Financë

”





I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi L.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit MP në “Bankë - Financë”, i ofruar nga Departamenti Financë – Kontabilitet, në Fakultetin e Biznesit të UAMD, përmban lëndë dhe kurrikula të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare. Plani strategjik i programit, (pika “Misioni”, fq. 3) përcakton se ky program “është projektuar për përgatitjen e studentëve që të bëhen qytetarë të mirë, udhëheqës të përgatitur në të ardhmen e të orientuar drejt zgjidhjeve të problematikave në çështjet lokale, rajonale dhe kombëtare”. (Plani strategjik për zhillimin e programit Master Profesional “Bankë-Finance”, misioni, qëllimet, pika 2, fq. 3)
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Plani strategjik i programit, (pika “Misioni”, fq.3) shpreh se “programet e studimit synojnë në konsolidimin e vlerave akademike kulturore e kombëtare” dhe është në përputhje me Statutin e UAMD, neni 3, pika 1c dhe 1d ku përcaktohet se UAMD ka si synim “të përgatisë profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane” (Statuti i UAMD, Neni3, pika 1c, 1d, Plani Strategjik i UAMD, Rregullore e programit të studimit)
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Rregullorja e programit Master Profesional “Bankë-Financë” është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM 41/2018 për elementët e studimit, në udhëzimet 15 dhe 31 të MAS, në Kodin e Cilësisë UAMD, në manualin e ASCAL për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin si edhe në Statutin dhe Rregulloren UAMD dhe në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit. Në këtë mënyrë programi i studimit i rregulluar nga kjo rregullore ofrohet në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë së tij të përcaktuara në statutin e tij. GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e UAMD ku në qendër është studenti dhe kjo gjë u konstatua edhe gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik, në




	ditët e vizitave në institucion. (Statuti, neni 4, pika 3, Plani i zhvillimit strategjik 2016-2020 UAM, Rregullorja UAMD, Rregullorja e FB, Rregullorja e programit MP “Bankë-Financë”, neni 2)		
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit MP “Bankë-Financë” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në “Strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021”, dhe përputhet me strukturën e ekonomisë shqiptare. Ky program synon të formojë specialistë me profil profesional në fushën Bankë-Financë.</p> <p>GVJ shënon së studimi i radhës nuk i referohet tregut të punës, por studentëve që kanë përfunduar këtë program dhe është kryer në 2018, 10 vite pas hapjes së tij. Ky fakt krijon një hapësirë kohe pa informacion për të vlerësuar saktësisht përputhshmërinë e programit me ecurinë e tregut.</p> <p><i>Evidenca 14 Dosja e plotë e hapjes së programit 2010;</i> <i>Evidenca 16 Studimi i tregut të punës para hapjes së programit;</i> <i>Evidenca 111 Nevojat e tregut për profesionistë në degën Bankë-Financë në vitin 2014</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional “Bankë-Financë” është në përputhje e në zbatim me planin strategjik të UAMD.</p> <p>Strategjia e institucionit përcakton në pikën 8 të saj “ofrimin e programeve studimore në përputhje me nevojat e tregut të punës”, si dhe saktëson si prioritete “garantimin e përgatitjes cilësore dhe suksesit të studentëve, ekselencë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe pjesëmarrje intensive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare”. Plani strategjik i programit është në përputhje me planin strategjik institucional sipas</p>






	<p>prioriteteve të vendosura e të sipërpërmendura.</p> <p><i>(Plani Strategjik i UAMD Plani strategjik për zhillimin e programit Master Profesional "Bankë-Finance")</i></p>			
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Bazuar në analizën e dokumentave strategjikë të institucionit, <i>(Statuti, Plani Strategjik, Rregullorja e Fakultetit të Biznesit dhe Departamentit)</i>, dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra ky program ndjek dhe zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>(Plani Strategjik i UAMD Plani strategjik për zhillimin e programit Master Profesional "Bankë-Finance")</i></p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Ky program studimi është në zbatim të VKM nr 41 Dt.24.01.2018. Programi ofrohet nga Departamenti Financë – Kontabilitet, Fakulteti i Biznesit, dhe është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UAMD-së, me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij.</p> <p><i>(Plani Strategjik i UAMD Plani strategjik për zhillimin e programit Master Profesional "Bankë-Finance")</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentave bazë dhe vizita në institucion e GVJ, konfirmon se programi i studimit MP "Bankë - Financë" është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në "Strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021", dhe përputhet me trendet globale të zhvillimit ku industria e financës ka një rol të rëndësishëm.</p> <p><i>(Plani Strategjik i UAMD, Plani strategjik për zhillimin e programit Master Profesional "Bankë-Finance", Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>			<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.3

Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------


<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se programi i studimit MP “Bankë –Financë”, ka si mision: përgatitjen e profesionistëve të fushës së bankës dhe financës me standartet më të larta akademike bashkëkohore duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve të vazhdueshmë të ekonomisë.</p> <p>Ndër objektivat formues të programit përfshihen dijet, kompetencat dhe aftësitë që studentët e programit duhet të fitojnë në përfundim të tij dhe këto janë në përputhje me atë që kërkon tregu, sipas studimit fillestar të kryer përpara hapjes së programit.</p> <p><i>Duhet shënuar gjithsesi së kërkesa e tregut është përcaktuar në një studim të tregut të punës përpara hapjes së programit, në 2009 dhe nuk është përditësuar më tej.</i></p> <p>GVJ shënon se studimi i radhës nuk i referohet tregut të punës, por studentëve që kanë përfunduar këtë program dhe është kryer në 2018, 10 vite pas hapjes së tij. Ky fakt krijon një hapësirë kohe pa informacion për të vlerësuar saktësisht përputhshmërinë e programit me ecurinë e tregut.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim paraprak tregu përpara hapjes së programit dhe ka bërë disa kërkime për të evidentuar më tej kërkesën në tregun bankar (<i>referohemi evidences 111</i>), por institucioni nuk disponon të dhëna të analizuara dhe konkluzione konkrete të një studimi të mirëfilltë tregu për të parë edhe zhvillimet e pritshme të sektorit të financës në mënyrë periodike. Në vijim në studimin e tregut të punës pas mbarimit të studentëve vërehen disa tregues të punësimit ku:</p> <p>30% e tyre janë të punësuar si ekonomistë në sektorin privat;</p> <p>6% janë punësuar në banka;</p> <p>2% janë të punësuar si kontabilistë;</p> <p>34% në sektorë publik ose privat;</p> <p>28% janë të papunë;</p> <p><i>(Evidenca 111 Nevojat e tregut për profesionistë në degën Bankë-Financë, Evidenca 16 Studimi i tregut para hapjes, Evidenca 17 Studimi për tregun e punës pas diplomimit)</i></p> <p><i>GVJ rekomandon, të analizohen më tej të dhënat e punësimit dhe përkthehen në strategji për përmirësimin e programit të studimit në aspektin e objektivave dhe të</i></p>






	<i>mundësive të punësimit që ky program ofron.</i>
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	<p>Programi i studimit MP në “Bankë – Financë” ka objektiva formues të përcaktuar qartë që konsistojnë në rritjen e kapacitetit, të aftësive dhe të profesionalizmit të studentit që ose gjëndet ose do të hyjë pas këtij programi në tregun e punës. Përmbajtja e programit mësimor me lëndë të fushës si: Drejtimi Financiar, Menaxhimi i Riskut, Kontabiliteti Financiar, e garantojnë dhe i përgjigjen profesionit të fushës së Bankë-Financë. Por në rishikim të kurrikulës së ofruar GVJ konstatoi se pjesë e planit mësimor në lëndët bazë të detyrueshme përfshihen lëndë të avancuara të cilat nuk i përkasin drejtpërdrejt fushës Bankë-Financë edhe pas rishikimit të kurrikulës në 2018.</p> <p><i>GVJ sygjeron, që të riorganizohet grupi i lëndëve bazë duke përfshirë më tepër lëndë të profilit të Bankë-Financë-ve, për ti ardhur më në ndihmë formimit profesional të studentëve në këtë fushë specifike dhe për të lehtësuar punësimin e tyre.</i></p> <p><i>(Evidenca 91 Riorganizimi i programit të studimit MP B-F, viti 2018)</i></p>
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	<p>Sipas dokumentacionit të ofruar nga Institucioni (evidenca 68) programe të shkollave Ekonomike/të Biznesit nga India, SHBA, Zelanda e Re, Australia dhe Sllovenia janë marrë parasysh për të krahasuar programin e studimit në “Bankë-Financë”. Programi është ristrukturuar në vitin 2018 dhe gjatë takimeve me dekanin dhe shefin e departamentit mësuam se kurrikula e rishikuar është bazuar në kurrikula të ngjajshme të ofruara nga vendet e rajonit dhe BE, por për këtë nuk ka ndonjë evidencë të ngjashme përveç të sipërpërmendurës.</p> <p><i>GVJ bazuar në verifikimin e tij sa më sipër sugjeron se programi duhet riparë në aspektin e përmbushjes së objektivave të tij dhe, duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal, dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, si në Ballkan dhe BE, për të rritur konkurrueshmërinë e studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca 91 Riorganizimi i programit të studimit MP B-F, viti 2018, Evidenca 68 Programe të ngjashme ndërkombëtare</i></p>
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara	<p>Programi i studimit MP “Bankë-Financë” është hartuar bazuar në legjislacionin shqiptar i cili është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE. Programi është në përputhje me kërkesat e Bolonjës dhe suplementi i diplomës bazohet në modelin e hartuar nga Këshilli European.</p>




mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.			
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Sipas programit të studimit MP në “Bankë-Financë” në lëndët plotësuese parashikohet “praktika profesionale” me 6 kredite në përputhje të kërkesave të ligjit. Këtë detyrim studentët e plotësojnë duke kryer praktikën në institucionet ku ata aktualisht punojnë ose në institucione të tjera për të cilat Institucioni ofron mundësi, ose sipas mundësive që ata privatisht disponojnë. Koha e praktikës zgjat 3 muaj.</p> <p><i>GVJ duke u bazuar në faktin se ky program i përket një masteri profesional rekomandon, që Institucioni duhet të organizojë dhe instensifikojë marrëdhëniet me biznesin për të ofruar praktika edhe mundësi punësimi për studentët e programit, duke përmbushur edhe objektivat e programit.</i></p>		
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Kjo praktikë nuk aplikohet në këtë program. Programi është ofruar në gjuhën shqipe përgjatë gjithë kohës së funksionimit të tij.</p> <p><i>GVJ sugjeron se në përmbushje të objektivit të programit për të përgatitur profesionistë të fushës Bankë-Financë që të jenë konkurues në tregun ndërkombëtar, institucioni mund të rishikojë mundësinë për të ofruar lëndë në gjuhën angleze; kjo do të ishte një mundësi përthithje e studentëve të huaj.</i></p>		
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimi të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Programi aktual nuk është hapur përkohësisht. Ky program funksionon për 10 vite në treg dhe plotëson kerkesat e tregut ne fushen e Bankë-Financë. GVJ gjithsesi ka vërejtur nga dokumentacioni i parë se ka një ulje të numrit të studentëve rreth 4 viteve të fundit. Nga intervistimi me përfaqësues të institucionit kjo shpjegohet se ka ardhur si pasojë e hapjes së programit të studimit master shkencor në Financë, program që rezulton më i preferuar dhe i parapëlqyer prej studentëve.</p> <p>Për këtë arsye ndoshta duhet riparë nëse duhet të diferencohet roli i dy programeve në aspektin kurrikular dhe në tregun tek i cili ofrohet.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka në dispozicion burimet njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij. Staf i Fakultetit është me përvojë dhe i kualifikuar (pjesa më e madhe), në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në Zyrën e burimeve njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re që rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>RVB e Fakultetit të Biznesit 2018-2019</i>), Fakulteti i Biznesit për vitin akademik 2018-2019 ka gjithsej 136 pedagogë nga ku 69 pedagogë efektivë (PAE), nga të cilët: 5 pedagogë kanë titullin Profesor Doktor, 12 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 33 kanë gradën Dr, dhe 19 Asistent Lektorë me Msc, dhe 67 pedagogë me kontratë (PAK).</p> <p>Ndërsa për Departamentin rezultojnë 17 staf akademik efektiv (PAE) dhe 14 staf akademik me kontratë (PAK).</p> <p><i>Sugjerohet një mbajtje me e regullt dhe me të gjithë dokumentacionin perkates të përditësuar në të njëjtin ambient, pasi universiteti kishte arkiva në dy vende.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Financë - Kontabilitet që është njësi bazë e ofrimit të tij.</p> <p>Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Ky program referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me 60 ETC dhe kohëzgjatje 1 vit akademik, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë,</p>	<p>GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Financë - Kontabilitet, si njësi bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve</p>





<p>përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	kombëtare e evropiane.			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	Programi i ciklit të dytë MP në Bankë Financë, është tërësisht në drejtimin specifik brenda profilit të institucionit.			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit njëria baze përgjegjëse është Departamenti i Financë-Kontabilitet, me detyrën për të përmbushur qëllimin e programit. Departamenti mbulon me staf të kualifikuar shumicën e lëndëve/ moduleve të programit, ndërsa për pjesën tjetër angazhon staf nga departamentet e tjera të Fakultetit dhe staf të jashtëm. Përveç drejtuesit të Departamentit i cili kishte një rol kryesor në koordinimin e programit, UAMD ka në strukturën e tij Koordinatorin e programit, roli dhe funksioni i të cilit është kryesisht administrativ. Koordinatorin e programit luan më shumë rolin e një ndërmjetësi midis studentëve dhe institucionit se sa të një personeli akademik që ndjek përmbajtjen dhe cilësinë e ekzekutimit të programit të</p>




	studimit. I gjithë procesi, pra për mbikqyrjen dhe mbarevajtjen e programit të studimit u konstatua që bëhet në mënyrë të kordinuar nga të gjitha hallkat përgjegjëse dhe drejtuese e strukturës (organigrames) së UAMD.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe takimeve me studentët si dhe stafin, GVJ konstatoi se UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit (<i>referuar Marreveshjeve te bashkepunimit</i>).
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij program studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, ajo shoqërohet me 6 kredite (ECTS), dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj. UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve. Konstatohet se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve nuk është i mirë organizuar dhe funksional. (<i>referuar Marreveshjeve te bashkepunimit</i>)
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Bashkëpunimi ndërmjet UAMD dhe bizneseve për bërjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, bëhet nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të vecanta. Gjithsesi u konstatua se institucioni/biznesi ku studentët kryejnë praktikën është e lidhur me fushën e studimit.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni nuk ofron trajnime profesionale për studentët e diplomuar ndër vite, mbas diplomimit të tyre. Raportet dhe lidhjet e njësisë bazë me ish të diplomuarit dhe me karrierën e tyre mbas diplomimit janë të dobëta.
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Institucioni kryen analiza periodike të përfitimeve nga marrëveshjet (<i>Evidenca 35</i>), dhe i përfshin këto analiza në raportet e departamentit, fakultetit dhe Zyrës së projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë.




Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MP në “Bankë-Financë” i riorganizuar në vitin 2018 përmban lëndë sipas ligjit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë 1; - Lëndë karakterizuese 3; - Lëndë ndërdisiplinore 4; - Lëndë integruese 4; - Lëndë plotësuese 1; - Detyrime përmbyllëse 1; <p>Lëndët bazë dhe karakterizuese përbëjnë 5 ECTS dhe 21 ECTS përkatësisht, ndërsa nga lëndët ndërdisiplinore dhe integruese të cialt janë 8 në total, përzgjidhen 3 të cilat perbejne 18 ECTS. Lënda plotësuese është praktika profesionale me 6 ECTS dhe detyrimi përmbylles me 10 ECTS.</p> <p>Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studentët përfitojnë 60 ECTS.</p> <p>(Evidenca 91)</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Bankë-Financë” synon vecanërisht në përgatitjen e profesionistëve në fushën e drejtimit financiar, si pjesë e shumellojshmërisë së formimit profesional të njohjes së tregjeve financiare, të instrumentave financiare e të drejtimit të riskut.</p> <p>(Objektivat e programit MP ne Banke-Financë”)</p>




<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Bankë-Financë” përfshin module si Menaxhimi i Riskut, Drejtimi financiar i Avancuar apo Amvisim Portofoli, që kanë si qëllim jo vetëm njohjen me teorinë, por aplikimin e tyre në praktikë, si lëndë të avancuara.</p> <p>Gjithsesi duhet nënvizuar se njohuritë e avancuara në fushën e marketingut, sistemit tatimor dhe doganor apo të drejtimit të projekteve janë jashtë kontekstit të fushës Bankë – Financë. Këto lloj lëndësh mund të jenë lëndë me zgjedhje për studentët që ju nevojiten në punësimin e tyre apo kanë dëshirë të zgjerojnë njohuritë në fushat e sipërpermendura.</p> <p><i>Përfshirja në program e një numri të konsiderueshëm lëndësh të avancuara, i japin programit më shumë pamjen e një programi studimi Master shkencor se sa profesional.</i></p> <p><i>(Evidenca 91, kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Bankë-Financë” përfshin module që zhvillojnë njohuritë e studentëve në fushën profesionale Bankë – Financë. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion në lidhje me përmbajtjen e këtyre lëndëve vihet re se në disa prej tyre:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajtohen shumë çështje dhe koncepte të cilat studentët i kanë parë edhe në bachelor, duke e bërë programin të ngjajë më tepër si enciklopedi financiare dhe jo si njohuri specifike në fushën e specializuar të studimit (p.sh. Drejtimi Financiar i Avancuar, Shoqeri Sigurimesh, Menaxhim Risku). Në syllabusat e lëndëve dhe të moduleve ka një numër shumë të madh konceptesh dhe fjalë kyce, të cilat e bëjnë praktikisht të pamundur përvetësimin e njohurive. Kjo shumëllojshmëri tematikash mund të krijojë konfuzion tek studenti; 2. Literatura e detyrueshme shkon deri në 700 faqe dhe ka vetëm një burim. Në katër prej lëndëve (Drejtimit Financiar i Avancuar, Shoqëri Sigurimesh, Menaxhim Risku, Kontabiliteti Financiar) të programit literatura e detyrueshme është i njëjti libër. Po i njëjti libër përdoret edhe në bachelor sic është konfirmuar edhe nga intervistat gjatë vizitës në institucion; 3. Ka përsëritje të tematikave midis syllabeve të lëndëve të ndryshme psh. temat 3, 4, 7 dhe 10 të lëndës Amvisim Portofoli përsëriten edhe në lëndë të tjera; 4. Literatura e detyrueshme për lëndën Amvisim Portofoli është në gjuhën angleze dhe pas verifikimit të GVB nuk ekzistonte kopje të literaturës të disponueshme për studentin në




	<p>bibliotekë;</p> <p>5. Disa lëndë si Drejtim Projektsh, Sistemi Tatimor dhe Doganor, dhe Marketing i Avancuar duket sikur janë përfshirë mekanikisht në këtë program studimi, pasi jo të gjitha janë të fushës Bankë-Financë. Aq njohuri sa ju duhen nga këto fusha, studentët gjykohet se i kanë marrë në nivelin bachelor;</p> <p>6. Lëndë si Kontabiliteti Financiar dhe Kontabiliteti i Institucioneve Financiare mund të kombinohen pasi konsiderohen si lëndë bazë bachelor;</p> <p><i>(Evidenca 91, kuadri i pergjithshem formues i programit te studimit, sillabet e lendeve)</i></p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bankë – Financë përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sic është përcaktuar nga ligji, duke përcaktuar strukturën e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur, sipas viteve dhe semestrave.</p> <p><i>(Evidenca 91, plani mesimor me perberesit specifike sipas kuadrit ligjor ne fuqi)</i></p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bankë – Financë përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit dhe me ngarkesën si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndë bazë: 8.3% 2. Lëndë karakterizuese: 35% 3. Lëndë ndërdisiplinore: 30% 4. Lëndë plotësuese: 10% dhe 5. Detyrime përmblyese: 16,7%. <p>Sa më sipër janë konform ligjit në fuqi.</p> <p><i>(Evidenca 91, kuadri i pergjithshem formues i programit te studimit)</i></p>
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se në planin mësimor të programit Mp në Bankë – Financë, për praktiken profesionale, janë parashikuar 6 kredite, pesha në kredite është në përputhje me VKM nr 41.</p> <p><i>(Evidenca 91, kuadri i pergjithshem formues i programit te studimit)</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi MP në “ Bankë - Financë” ofrohet nga Departamenti Financë-Kontabilitet, i cili i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Departamenti i Financë-Kontabilitet e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Grupi i vlerësimit të brëndshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të këtij program studimi.</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Fakulteti i Biznesit është hapur me <i>VKM, Nr. 801, dt 20.12.2006</i>, si një nga njësitë kryesore të (UAMD). Kur u krijua njëri me emrin Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, ndërsa që prej vitit 2010 emërtohet si “Fakulteti i Biznesit” (FB). Fakulteti aktualisht përbëhet nga 5 departamente:</p>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Financë-Kontabilitet; 2. Departamenti i Menaxhimit; 3. Departamenti i Marketingut; 4. Departamenti i Shkencave Ekonomike; 5. Departamenti i Turizmit; <p>(Referuar evidences 56 RVB e Fakultetit të Biznesit 2018-2019), Fakulteti i Biznesit pranë UAMD në vitin akademik 2018-2019, ka në përbërje të tij gjithsej 136 pedagogë nga ku 69 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE), dhe 67 pedagogë me kontratë (PAK) të organizuar në 5 departamente. Përbërja e departamenteve në raportet PAE / PAK është si më poshtë:</p>
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Departamenti i Financë-Kontabilitet, përbëhet nga: (17 PAE / 14 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 12 / 14;</p>





	<p><u>Departamenti i Menaxhimit</u>, përbëhet nga: (14 PAE / 10 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 11 / 10;</p> <p><u>Departamenti i Marketingut</u>, përbëhet nga: (15 PAE / 20 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 12 / 5;</p> <p><u>Departamenti i Shkencave Ekonomike</u>, përbëhet nga: (15 PAE / 7 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 11 / 1;</p> <p><u>Departamenti i Turizmit</u>, përbëhet nga: (8 PAE / 11 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 7 / 11;</p> <p>Departamenti Financë-Kontabilitet, pjesë e Fakultetit të Biznesit ka rregulloren dhe strategjinë e vet. Drejtohet nga një përgjegjës që zgjidhet me zgjedhje të lira dhe ka personel të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë për ofrimin e programeve. Departamenti Financë-Kontabilitet, ka 17 personel akademik efektiv, nga të cilët me titull akademik: 1 Profesor i Asociuar dhe 11 me PHD, ndërsa 5 janë me master.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Programi MP në “Bankë-Financë” ofrohet nga Departamenti Financë-Kontabilitet, i cili i përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe stafin akademik. Ky Departament ka 5 personel akademik ndihmës për realizimin e programit.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Programi MP në “Bankë-Financë” ofrohet nga Departamenti Financë-Kontabilitet, i cili ka caktuar si person përgjegjës në rolin e kordinatorit Znj. Bitila Shosha. Sipas intervistës me personin roli i kordinatorit konsiston në koordinimin e programit, analizën e të dhënave statistikore, kontrollin raportimin dhe komunikimin me studentët për problemet e tyre. Nuk ka rol në vendimarrje dhe nuk është pjesë e pranimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Kordinatorin e programit është në kontakt të drejtpërdrejtë me përgjegjësin e Departamentit në lidhje me ecurinë e programit gjë të cilën GVJ e konfirmoi nga të dyja palët komunikuese.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin MP në Bankë Financë, njësia kryesore dhe ajo bazë disponon të gjithë dokumentacionin lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ku përfshihen, statuti UAMD, rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit, rregullorja e programit MP Bankë-Financë, plani strategjik për zhvillimin e programit, plani mësimor, sillabet lëndore etj.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit MP në Bankë – Financë përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit dhe me ngarkesën si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Lëndë baze: 8.3%; 2. Lëndë karakterizuese: 35%; 3. Lëndë nderdisiplinore: 30%; 4. Lëndë plotësuese: 10%; 5. Detyrime permbyllese: 16,7%; Sa më sipër janë konform ligjit në fuqi. <i>(Evidenca 91, kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit)</i>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit MP në “Bankë-Financë” i riorganizuar në vitin 2018 përmban lëndë sipas ligjit: bazë: 1, karakterizuese: 3, ndërdisiplinore: 4, integruese: 4, plotësuese: 1 dhe detyrime permbyllese 1. Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studenti përfiton 60ECTS. <i>(Evidenca 91)</i>
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën	Programi i studimit MP në Bankë – Financë përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sic është përcaktuar nga ligji, duke përcaktuar strukturën e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur,




<p>mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>sipas viteve dhe semestrave si dhe frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Skema e vlerësimit është e njëjtë në të gjitha lëndët. Mënyra e vlerësimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • provimi i ndërmjetëm (vlerësohet me 400 pikë në total) • provimi përfundimtar (vlerësohet me 500 në total) • detyrat e kursit 100 pikë të mundshme) <p>(Evidenca 91, plani mesimor me perberesit specifike sipas kuadrit ligjor ne fuqi)</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MP në Bankë – Financë ka rregulloren e vet ku përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve në nenet 31-33.</p> <p>(Rregullorja e Programi MP “Bankë-Financë”)</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit MP në Bankë – Financë përmban të gjithë informacionin lëndor dhe praktikatat që lidhen me të si dhe të gjithë elementët formues të programit sipas kërkesave të ligjit dhe rregulloreve të brendshme të Fakultetit.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar.</p> <p>(Rregullorja e Programi MP “Bankë-Financë”, Evidenca 91)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit MP në Bankë – Financë ka pësuar ndryshime që prej hapjes së tij në dy momente kohore, sic është konstatuar nga dokumentacioni dhe intervistat në institucion:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në 2014-2015 për sa i përket përmbajtjes së syllabeve, sipas takimit me pergjegjesen e Departamentit ky rishikim i përkiste njehsimit të termave të përdorura në shqip dhe anglisht dhe prerjeve të tematikave nga lëndë të ndryshme. Kjo nuk është e dokumentuar; 2. Në 2018 është bërë riorganizim i plotë i programit të studimit. Kjo është e dokumentuar; <p>Nga intervista GVJ konstatoi se programi lëndor (sillabet) diskutohen në fillim të cdo viti akademik dhe</p>





	dokumentacioni firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit MP në Bankë– Financë është strukturuar me module 5, 6, 7, dhe 10 ECTS. Në përfundim të studimeve student fiton 60 ECTS. Programi është në përputhje me ligjet në fuqi. (Evidenca 91)
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive kryesisht mundësojnë thellimin e njohurive të fushës, si psh Drejtimi Financiar i Avancuar apo Menaxhimi i Riskut. Por në lidhje me përmbajtjen e tyre vërehen prerje të lëndëve, ngjeshje të koncepteve dhe përdorim i të njëjtës literaturë në lëndë të ndryshme, dhe i së njëjtës literaturë me bachelorin në disa raste. (Evidenca 91)
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Sipas planit mësimor të riorganizimit të programit në vitin 2018 është përcaktuar se shpërndarja e moduleve ndër vite ka qenë 5 lëndë semestrin e parë dhe 4 në semestrin e dytë. Në planet mësimore të viteve 2013 – 2018 vihet re një ndarje jo strikte e këtij programi. Kjo ka ardhur si pasojë e infrastrukturës së viteve mëparë që nuk mundësonte mësimdhënien sipas planit. Por kjo ishte tejkaluar tashmë. Vlerësimi i lëndëve në kredite e mundëson arritjen e objektivave të programit. (Evidenca 91)
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite,	Struktura e programit me të gjitha elementët që e shoqërojnë janë në përputhje me profilin e programit. Disa përjashtime që janë përmendur edhe te standarti II.1, kriteri 4 lidhur me




<p>raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>përputhjen e disa lëndëve me profilin. Në lidhje me programet e tjera ndërkombëtare GVJ mendon se përafrimi ndërkombëtar duhet të jetë në fillim gjeografik rajonal në Ballkan dhe Europë, gjë të cilën nuk e konfirmon në këtë rast.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese ndjek kërkesat ligjore, por GVJ mendon se në një master profesional <i>raporti teori praktikë duhet të favorizojë më tepër praktikën në mënyrë që të arrihen objektivat e programit por edhe në funksion të punësimit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Sillabet e lëndëve ndjekin procesin e përditësimit cdo vit akademik, fakt i konfirmuar nga stafi i Departamentit dhe nga përgjegjesi i saj. GVJ në rishikim të dokumentacionit vëren se sillabet lëndore të rishikuar në vitin 2018 nuk kanë të përditësuar literaturën e tyre sipas kërkesave ligjore në lidhje me 5 vitet e fundit (disa lëndë përdorin të njëjtin autor si burim literature, Drejtim Financiar i Avancuar, Amvisim Portofoli, KONTabilitet i Ndërmjetëm. Etj).</p> <p><i>(evidenca 91)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ gjykon nga përmbajtja e programeve të lëndëve se për këtë nivel studimi të ciklit të dytë se disa nga lëndët janë të mbi ngarkuara me tematika, koncepte bazë apo përsëritje tematikash: psh në lëndën Drejtim Financiar i Avancuar temat 2, 6, 11 janë tematika të mbuluara në nivelin e parë, ose në lëndën Amvisim Portofoli temat 3, 4, 7, 10 përsëriten edhe ë lëndë të tjera.</p>
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Duke marrë parasysh dhe sa janë përmendur në kriterin 7 më sipër, GVJ gjykon se ky program ka mangësi në lidhje me ofrimin e thelluar profesional për arsye:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përsëritje të koncepteve bazë në disa module; 2. Mangësi në lidhje me kombinimin praktikë teori; 3. Përfshirje të lëndëve jo të fushës “Bankë-Financë”; <p><i>(evidenca 91)</i></p>
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e</p>	<p>GVJ gjykon se përmbajtja e programit e mundëson ecurinë e studentëve në studime të mëtejshme, por në lidhje me tregun e punës dhe duke u bazuar te studimi i tregut të punës një përqindje e madhe e studentëve nuk janë punësuar, cka bën të vlerësohet se ndoshta nuk ka një përqindje të lartë përshtatje</p>





kërkesat e tregut e punës.	me pritshmëritë e tregut të punës.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi; pedagogët që mbulojnë nevojat e programit janë me titull Dr, përvec njërit i cili është me gradë kandidat doktorant. (evidenca "Plani mesimor për vitin akademik 2018-2019).
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	GVJ konstaton se programi MP në "Bankë-Financë" mbulohet me staf akademik efektiv dhe staf akademik me kontratë. Në bazë të (evidences 175 Plani mesimor për vitin akademik 2018-2019), modulet e ofruara janë mbuluar 5/8 lëndë me pedagogë të jashtëm dhe 3 module nga pedagogë të brendshëm. Gjatë intervistës me përgjegjësen e Departamentit është konfirmuar se mbulimi në masën 70% me staf të brendshëm për këtë program nuk ka qënë i mundur. Për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 8 pedagogë (5 PAE / 3 PAK): - 1 Prof.Asoc; - 5 Dr; - 2 Msc; Mbulimi i programit në përqindje është 62.5% PAE. Për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 7 pedagogë (2 PAE / 5 PAK): - 2 Prof.Asoc; - 4 Dr; - 1 Msc; Mbulimi i programit në përqindje është 28.5% PAE. Referuar (evidences ngarkesa mesimore 2019-2020, <i>sem I</i>),




	<p>kërkuar gjatë vizitës;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 4 pedagogë (3 PAE / 1PAK):</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Asoc; - 2Dr; - 1 Msc; <p>Mbulimi i programit në përqindje është 75% PAE.</p> <p>Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020, vërehet se stafi akademik efektiv (PAE) ka një ngarkesë prej 465 orësh në total nga 585 orë mësimore, që përbën 79,5% të totalit të orëve që mbulohen nga staf i efektiv.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në Institucion, GVJ konstatoi se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion dhe marrëveshjeve në fuqi si dhe nga takimi me studentët, UAMD ofron mundësinë për të udhëzuar studentët në praktikën e tyre profesionale. Duke qenë se një pjesë e studentëve janë të punësuar, në pjesën më të madhe institucioni ofron mbështetje në lidhje me temën e diplomës. Po ashtu institucioni mundëson lektorë të huaj, me gjithë që kjo nuk kishte ndodhur në këtë program, apo leksione të hapura. Nga takimi i GVJ me përfaqësues të zyrës së Alumni u pohua se një pedagog është përgjegjës për mentorimin e 20 studentëve. Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p><i>(evidenca 35 dhe 142).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm 100% për programin në fjalë. Nga diskutimi me studentët ata kryesisht i kryejnë punimet në ambjentet personale dhe jo në laboratorët e shkollës. Por nga ana e vet UAMD nëpërmjet ndërtesës së re ofron hapësira dhe laboratorë të pajisur me kompjutera.</p>




mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Përmirësimi dhe rishikimi i programit MP në Bankë-Financë është kryer në vitin 2018. Për këtë janë marrë parasysh studimet e kryera (<i>evidence 16 dhe 17</i>). Por në Komisionin e rishikimit të kurrikulës nuk përfshihen aktorë nga biznesi apo aktorë të tjerë të tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Nëpërmjet Drejtorisë së kurrikulës dhe standarteve të cilësisë institucioni ka filluar procesin e përfshirjes së studentëve në përmirësimin e programeve. Kjo kryhet nëpërmjet pyetësoreve që Drejtoria ka hartuar dhe analizon. Gjithsesi është akoma në fazë primare për të përcaktuar nëse reflektimi i propozimeve të studentëve në lidhje me programin e studimit është kryer për shkak të evidencave të pa mjaftueshme në lidhje me këtë.
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Institucioni ka kryer një studim për tregun pas diplomimit, iniciativë të cilën GVJ e konsideron shumë të vlefshme në lidhje me vendimet strategjike në lidhje me programin por edhe me koordinimin administrativ të tij. Sugjerime të studentëve lidhur me orët mësimore, sekretarinë dhe praktikën janë marrë në konsideratë nga institucioni dhe janë përmirësuar sic GVJ ka mundur të konstatojë nga intervista me studentët aktualë. Paralelisht Zyra e ALUMNI e krijuar ne Universitet ka ndërmarë një nisëm për gjurmimin e studentëve të diplomuar






	në mënyrë që të krijohet një databazë me këta studentë. Deri tani gjurmimet për programin MP në “Bankë-Financë kanë arritur në 25 emra. Kjo strukturë gjithësesi është e re dhe ka përpara një mision shumë të rëndësishëm. GVJ njeh përpjekjen e institucionit për të përmbushur këtë kriter.		
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Nevojat specifike lokale të identifikuara nga institucioni nëpërmjet studimit të tregut janë reflektuar në rishikimin e kurrikulës të vitit 2018. Lëndët “Sistemi tatimor dhe doganor” dhe “Kontabiliteti i Institucioneve Financiare” i përgjigjen më shumë të diplomuarve që kanë qenë të punësuar në këto fusha. Si pasojë edhe nevojat specifike lokale janë pasqyruar në këtë rishikim.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Zhvillimi i procesit mësimor realizohet sipas metodave klasike. Në këtë institucion të arsimit të lartë janë adaptuar sistemet e mësimdhënies dhe të vlerësimit sipas modelit amerikan, me procesmësimdhënës pa ndarje klasike midis leksioneve dhe semirave dhe me sistemin e vlerësimit me 1000 pikë, nga të cilat 100 pikë punime të pavarura, 400 pikë provim dhe kontroll pjesor dhe 500 pike vlerësimi në provimin përfundimtar. Sipas (evidencës 39) në lidhje me metodat interaktive të përdorura në mësimdhënie, GVJ konstatoi se UAMD nxit zhvillimin e përdorimit të metodave interaktive dhe inovative

	<p>të mësimdhënies. Stafi akademik është pjesë e marrëveshjeve të mobilitetit të cilat janë zbatuar edhe për stafin e fakultetit me synim rritjen profesionale të tyre nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet e huaja. Për më tepër ngritja e komisioneve të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe rregullorja e NJSBC monitoron rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Nga takimi me stafin akademik dhe me studentet, GVJ konstatoi se përdorimi i metodave interaktive përfshinte përdorimin e softëare-eve të kontabilitetit apo case study nga realiteti për t'i bërë modulet sa më praktike.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p><i>Nuk rezulton që të përdoren vlerësime të diferencuara midis pedagogësh dhe që synojnë stimulimin dhe inkurajimin e pedagogëve që aplikojnë metoda të reja dhe bashkëkohore.</i></p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët. Vlerësimi i performancës kryhet në fund të çdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore.</p> <p><i>Rekomandohet që këto kontrole të kryhen në bashkërendim me NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Forma më e përdorur për këtë ka qënë organizimi i anketave dhe pyetësoreve, të cilët përpilohen në bashkëpunim me zyrën e karrierës dhe të kontrollit të cilësisë. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësoreve (<i>Rregullorja e NJSBC, neni 6</i>), si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit (<i>parashikuar në Rregulloren e Fakulteti të Biznesit, neni 83</i>).</p> <p>Sipas konstatimit të GVJ rezultatet e pyetësoreve bëheshin të ditura në mbledhje departamentale dhe trajtoheshin me sensitivitet për kundrejt pedagogut përkatës. Në raste për të cilat është nevojitur trajnim i pedagogëve në lidhje me</p>




	aftesitë e tyre komunikuese dhe metodikën në auditor, është mundësuar mbështetja përkatëse nga Fakulteti i Edukimit me seminare të ndryshme. <i>Sugjerohet që pyetësoret të kryhen në bazë semsetrale në koordinim me NJSBC dhe përfundimet t'ju bëhen të ditura dhe studentëve.</i>		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Zyra përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë që është ngritur dhe funksionon në nivel universiteti, harton raporte dhe i bën ato objekt diskutimi dhe analiza në senatin akademik. Nuk rezulton që në këto raporte të ketë të dhëna apo informacione që kanë të bëjnë me këtë program studimi. Paralelisht njësi bazë dhe kryesore (Departamenti dhe Fakulteti) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion parashikohet se Fakulteti i Biznesit përdor mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësi i studentëve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit, sic na është konfirmuar edhe në takimet me përgjegjësen e Departamentit. Por në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së departamentit të Financë-Kontabilitetit që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembuj të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit. (Evidenca 39, 58, 146, 166)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
		X	


Standardi III.2**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin**

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al





profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në lëndët dhe modulet e këtij program studimi përdoren format klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet, seminarët, ushtrimet, punimet e kursit, punët e pavarura, orë laboratorike, praktikë profesionale, tema diplome (<i>Statuti UAMD, neni 72; Rregullore UAMD, neni 60; Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 51; Rregullorja e programit MP në Banke-Finance, neni 9</i>).</p> <p>Programi përfshin 60 kredite në total nga të cilat 30 fitohen në semestrin e parë, 14 në semestrin e dytë, 6 praktika profesionale dhe 10 mikroteza.</p> <p>Orët/kreditet e këtij cikli studimesh janë:</p> <p>390 orë Orë në auditor;</p> <p>955 orë Përgatitja e studentit;</p> <p>155 orë Orë jashtë auditorit;</p> <p>1500 orë-60 kredite Totali;</p> <p>Praktikë profesionale: 6 kredite</p> <p>Detyrime përmbyllëse-Mikroteza: 10 kredite</p> <p>Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personal akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar.</p> <p>(<i>Evidenca 91 "Riorganizim i Programit MP në BANKë - Financë", "Plani mësimor MP Banke-Finance"</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Bazuar në informacionet e grumbulluara në takimet me studentët dhe stafin akademik të programit të studimit, në lëndë të ndryshme, stafi akademik aplikon metoda të ndryshme të zhvillimit të procesit mësimor, në funksion të natyrës dhe vecorive së çdo lënde dhe të bazës materiale të nevojshme.</p> <p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve janë të paraqitura në syllabuset dhe programet e lëndëve e moduleve. Format e mësimit teorik e praktik janë: leksionet dhe seminarët të integruara, ushtrimet, praktikat profesionale, vizita studimore pranë bizneseve, detyrat e kursit/projektet e kursit, etj. Format e kontrollit të dijeve janë testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe e</p>




	<p>projekteve të kursit, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit. Gjithashtu në UAMD organizohen leksione të hapura nga lektorë të ftuar të huaj ose vendas si edhe konkurse apo forma të ndryshme mësimore të parashikuara në Rregulloren e Fakultetit (<i>neni 51</i>) dhe Rregullore e Masterit (<i>neni 9</i>).</p> <p>Nuk rezulton të përdoren metoda të ndryshme dhe të diferencuara midis grupeve të ndryshme të studentëve. Stafi është i hapur për përmirësimin dhe pasurimin e metodave të mësimdhënies ndër vite.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Ne kuadrin e mbështetjes të procesit të mësimdhënies, stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive, duke bërë një kërkesë paraprake pranë sekretarisë mësimore pasi sallat nuk janë ende të pajisura me projektorë.</p> <p>Stafi ka mundësinë të marrë pjesë në mobilitete, ku sic është konstatuar janë përdorur prej tyre. Po ashtu Departamenti kryen aktivitete të ndryshme ku stafi ka marrë pjesë, si psh Konferenca të organizuara nga Fakulteti. GVJ vlerëson pozitivisht procesin e rishikimit të sillabuseve dhe tezave të kryer në 2014-ën, ku sic është konstatuar nga dokumentacioni dhe vizita stafi akademik ka marrë pjesë duke shprehur kërkesat/nevojat për ndryshim, duke ndarë metodiakt më të mira të mësimdhënies a duke ndarë eksperiencat vetjake ne favor dhe në funksion të rritjes së kompetencave didaktike.</p> <p><i>Po duhet të theksohet se për personelin akademik me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme nuk janë realizuar trajnime specifike që synojnë përmirësimin e procesit të mësimdhënies apo përmirësimin e kompetencave didaktike.</i> Gjykojmë se stafi akademik ka nevojë edhe për trajnime të karakterit pedagogjik dhe psikologjik për të njohur dhe marrë në konsideratë sjelljet e studentëve dhe vecoritë e tyre në tipa, karaktere dhe temperamente.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë të cilët janë ende në proces doktorature. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive. Ata kanë fituar një eksperiencë të kënaqshme, janë relativisht të rinj dhe kjo</p>






	<p>përbën një avantazh të dukshëm.</p> <p>Një pjesë e këtij personeli janë të angazhuar në proces mësimdhënës edhe në universitete të tjera brënda dhe jashtë vëndit dhe kjo përbën pa asnjë dyshim një avantazh të dukshëm dhe progres të evidentueshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni, kryesisht njësia bazë/Departamenti, vlerëson format e mësimdhënies dhe analizon performancën e këtij procesi. Për këtë Departamenti, si strukturë që drejton programin, analizon periodikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik; • Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor; • Realizon dhe tërheq opinionin e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies; <p>Kontrollet e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga dekanati dhe departamenti identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetëtori i studentëve</p> <p>Nuk është evidentuar ndonjë rast që të jetë realizuar ndryshimi apo reflektimi ndaj vrejtyeve dhe sugjerimeve studentëve lidhur me mësimdhënien.</p> <p><i>Në këtë aspekt institucioni duhet të hartojë një procedurë monitorimi të gjetjeve nga pyetësorët, një plan aksioni nga komisionet përkatëse dhe një monitorim i përmbushjes së planit. Duke qenë se NJSBC është strukture e re GVJ konstatoi se në këtë aspekt ka vend për përmirësim.</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Personeli akademik përdor diskutime të lira dhe metoda të tjera interaktive në orët e mësimi që synojnë përfshirjen dhe gjallërimin e shprehjes së lirë të ideve dhe të inkurajimit të studentëve për të përfituar nga ky diskutim.</p> <p>Nga vizita në institucion mësuam se personeli akademik përpiket që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimi, të përdorë case study nga Universitete të tjera, apo të përfshijë raste nga tregu lokal duke ruajtur anonimitetin e të dhënave</p>




	të përdorura.								
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Programi i studimit, edhe pse është i nivelit master profesional, nuk i është larguar formës klasike që është pothuaj i ngjashëm me nivelin bachelor. Programi ka më shumë karakter teorik dhe të thelluar se sa praktik dhe profesional. Studentët janë të varur nga kërkesat dhe detyrimet dhe nuk nxiten shumë për punë të pavarur. Në disa lëndë mund të përfshihen më shumë forma profesionale të ngjashme me ato të materializuara në praktikën profesionale. Midis pedagogëve dhe studentëve dominon respekti i ndërsjellë dhe reciprok si dhe fryma e ndërtimit të marrëdhënieve të ngrohta dhe komunitare.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							


Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Godina e re dhe kampusi i ri i UAMD mundësojnë që procesi mësimor e shkencor për programin e studimeve të zhvillohet brenda të gjithë parametrave moderne. Sipas orarit të mësimin semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione dhe seminare,) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambjentet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, ndihme të shpejtë. (Evidenca 170 Rregullorja e IT (neni 4&5), Evidenca 169 Rregullorja e Bibliotekes (neni 4&6).
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambjentet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me kompjutera e projektorë. Kampusi universitar i UAMD ku ndodhet

mësimor dhe praktikave.	Fakulteti i Biznesit, duke qenë një ndërtim i ri me standarte bashkëkohore teknike, ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m ² / student.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	UAMD ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Por nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ iu referua se pika të dobëta në department mbeten logjistika IT e programet kompjuterike. Gjithashtu, sic e përmendëm edhe më sipër, mbeten ende sallat e leksioneve për tu pajisur me kompjutera e projektorë.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Materialet fizike ofrohen në librarinë e Fakultetit të Biznesit. Biblioteka ofron tituj bazë dhe materiale mbështetëse në shqip si edhe në gjuhë të huaj, <i>por nga vizita në Bibliotekë rezultoi se numri ishte i kufizuar dhe botime te vjetra.</i> Në një rast me zgjedhje rastësore konstatoam se literaturë e detyrueshme ishte në gjuhën angleze dhe teksti përkatës nuk gjendej në bibliotekë. Megjithatë, studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë artikujt të ndryshëm si material mbështetëse nëpërmjet abonimit që universiteti ka bërë në EBSCO.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet tekste mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit. <i>GVJ rekomandon që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duhet te pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</i> Nga vizita në Institucion rezultoi që biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët dhe ka mungesa në tekste e




	detyrueshme.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Referuar RVB-së theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo rezultoi se nuk përdorej nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin. Universiteti përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH. Nevojitet të theksohet se kjo databazë nuk përfshin materialet e nevojshme për degën e ekonomisë.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UAMD ka salla konferencash dhe ambiente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Gjithashtu në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, janë edhe dy laboratorë të teknologjisë informacionit. Studentët po ashtu kanë specifikuar se nuk i përdorin laboratorët në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre, por komunikojnë kryesisht online.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Platformë online (e-learning) mbetet ende një sfidë e UAMD-së për tu realizuar në të ardhmen.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	UAMB ofron momentalisht akses në dokumentacionin elektronik vetëm për ciklin e parë të studimeve, ndërkohë po punohet për implementimin e tij në të ardhmen për ciklin e dytë të studimit.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Studenti ka të drejtë të propozojë sipas dëshires se tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekani i fakultetit, Rregullore e Tezes së Diplomimit (neni 2&3), Rregullorja e Diplomimit (neni 5&6). Gjatë punës kërkimore për arritjen e objektivave të përcaktuara në realizimin e punimit të diplomës, udhëheqësi asiston gjatë gjithë kohës studentin dhe e mbështet atë për përmbylljen me sukses të saj.






	Gjatë takimeve u referua se një pedagog udhëheq deri në 5 teza masteri. Problematika kryesore e pedagogëve është të evidentojë plagjiaturën, të cilën aktualisht nuk është në gjëndje ta bëjë me një softëare të dedikuar, por duke përdorur google, sic është referuar nga intervista me stafin akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, që nga muaji Maj 2019, është përgjegjëse për të siguruar cilësinë e programeve të studimit në UAMD dhe përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien (<i>neni 81 i rregullores së re në UAMD</i>).</p> <p><i>GVJ konstatoi pas diskutimeve, se kjo njësi e ka të vështirë të monitorojë të gjitha programet e ofruara nga UAMD. Për këtë arsye dhe si pasojë e nevojave imediate të institucionit për akreditimin e disa programeve studimore njëkohësisht, është ngritur NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse ku anëtarë janë shefat e cdo departamenti dhe 2 zv/dekanet. Fakulteti i Biznesit dhe Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërben për të patur një pasqyrë të fakultetit dhe për tu përmirësuar në vazhdimësi. Personi përgjegjës për cilësinë e mësimin dhe kurrikulat në nivel fakulteti aktualisht është Dekani. Ai ndjek dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore në Fakultetin e Biznesit.</i></p> <p>Rekomandojmë që NJSBC Qendrore e quajtur edhe “Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë” të shikojë mundësinë e shtimit të stafit të saj për të përballuar ngarkesën, si edhe ushtruar veprimtarinë e saj më aktivisht dhe e pavarur për të garantuar edhe transparencën.</p> <p>Kjo gjithashtu e rëndësishme edhe për përmbushjen (brenda vitit 2017-2018) e rekomandimit Nr.1 të lënë nga grupi i</p>

	vlerësimin mbi akreditimin insituacional.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti Kontabilitet – Financë bëjnë kontrole të vazhdueshme si edhe diskutime të brendëshme me synim rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Dekani si drejtues i fakultetit dhe Përgjegjësi i departamentit, si njësi bazë, duke u mbështetur në kontrollin e vazhdueshëm dhe masave të marra, të leksioneve të hapura të organizuara, si dhe të analizës së vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimit shkencor, krijon frymën e përgjegjësisë individuale të personelit akademik për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në këtë program studimi. <i>(Ref. Rregullorja e Programit, neni 10; rregullorja e Departamentit, neni 11; Rregullorja e Fakulteti të Biznesit, neni 21).</i>
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Leksionet e hapura nga lektorë të ftuar të huaj dhe vendas të organizuara në UAMD, pjesëmarrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Konferenca Studentore e organizuar me mbështetjen e stafit akademik, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. <i>Por natyrisht ka vend për përmirësim në këtë aspekt.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, zenë një vend të rëndësishëm në fokusin e aktiviteteve të UAMD, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies. <i>(Evidenca 43 dhe 58)</i>
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe	Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit të Biznesit dhe departamentit të Financë - Kontabilitete, kualifikohen brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione




implementimit të metodave të reja.	të tjera homologe përmes tryezave të rrumbullakta, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësime të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie. (Evidenca 39)		
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimi i programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Ky është një detyrim i cili rrjedh nga marrëdhëniet e punës që ka stafi akademik në lidhje me realizimin e procesit mësimor të përcaktuara në kontratën e punës. Në fillim të semestrit pedagogu harton planin kalendar të zhvillimit të leksioneve dhe seminareve, që firmoset nga ai dhe përgjegjësi i departamentit. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimit si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.		
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit.		
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Stafi akademik i Fakultetit të Biznesit ka përfituar 6 shkëmbime (referuar bisedës me Zyrën e Projekteve dhe Marrëdhënies me Jashtë), në kuadër të projekteve të mobilitetit që ka UAMD. Por ky angazhim nuk ka ndihmuar në rrjetizimin e universitetit dhe krijimin e vazhdimësisë së bashkëpunimit me institucionet partnere, te paktën deri në momentin aktual.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.5




Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, teste me alternativa përgjigjesh si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në (<i>Rregulloren e Fakultetit neni 59</i>), dhe në (<i>rregulloren e programit të studimit neni 17</i>).</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së UAMD realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegiumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; - detyrave të kursit për problematikën e disiplinës; - provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës; <p>Sistemi i vlerësimit të studentëve është i njëjtë për të gjitha programet në nivelin Master dhe realizohet nëpërmjet sistemit të pikëve 0-1000 të cilat konvertohen në nota (4-10). Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara ku ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive së bashku me plotësimin e detyrimeve (detyrave të kursit) vlerësohen me 10%, testimet gjatë vitit (ose provimi ndërmjetëm) me 40% dhe në fund kryhet provimi përfundimtar, i cili vlerësohet me 50%. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita ne institucion konstatoam se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës Studentët informohen rregullisht, në fillim të cdo semestri dhe përgjatë tij lidhur me lëndët, me syllabusat e cdo lënde dhe me kërkesat e</p>




<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>programit për studentët. Ata njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këture detyrimeve.</p> <p>Bazuar në rregulloret e studimeve të UAMD-së, (<i>Rregulloren e Fakultetit të Biznesit neni 59</i>), rregulloren e programit të studimit (neni 17), janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Vlerësimi dhe testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme.</p> <p>Më të përdorura në këtë program studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi me punime të pavarura, ose detyra kursi, të cilat realizohen në grup dhe që studentët kanë në dispozicion 10 % te vlerësimit vjetor nga ky element; - Për cdo lëndë, ka edhe një kontroll ose vlerësim të pjesshëm, që ka 40% të vlerësimit vjetor; - Vlerësimi përfundimtar që ka 50 % të vlerësimit vjetor; <p>Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse dhe mesatare. Grafiku i provimeve hartohet nga përgjegjësat e departamenteve dhe miratohet nga Dekani. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës pasi nuk ka titullar të modulit, dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin</p>	<p>Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:</p>




përfundimtar.	<p>1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit;</p> <p>2. Vlerësimi përfundimtar;</p> <p>Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për zbatimin e këtij kriteri, deri më tani korrigjimet bëhen nga pedagogët pasi sistemi elektronik i përdorur në të kaluarën nuk rezultoi efektiv. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>Sugjerohet përdorimi i një sistemi elektronik për të rritur transparencën në vlerësim.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Përgjegjësi i departamentit së bashku me komisionet e lëndëve janë përgjegjese për krijimin e komisioneve të provimit. Në përbërjen e tij ka së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është pedagogu nga i cili buron lënda/moduli, dhe që është përcaktuar në syllabus, apo ka të njëjtin profil ose të përafert. Komisioni i provimit përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive dhe dijeve me shkrim për momentin nuk bëhen në mënyrë anonime.</p> <p><i>Sugjerohet që fletoret e provimeve të sekretohen.</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit (kjo bëhet në forma të ndryshme sipas rastit në ppt, foto, video në orët e fundit të seminareve). Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar</p>




	ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/ përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Hartimi i tezave të reja bëhet për çdo sezon provimi si dhe të paktën në dy variante. Personelit akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të UAMD, me përjashtim të drejtuesit të departamentit apo personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani/Rektori/Rektorati për të kryer kontrole. Studentëve nuk u lejohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj. Është rritur kërkesa ndaj studentëve që mbrojnë temat e diplomave për të shmangur plagjiaturen. Vetë stafi akademik mundohet të kontrollojë plagjiaturën nëpërmjet mjeteve të disponueshme online si google scholar.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Gjatë proçesit të kontrollit stafi shënon pikët për çdo ushtrim si dhe tregohet i kujdesshëm të përfshijnë të gjithë informacionet e marra gjatë zhvillimit të lëndës/modulit dhe kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit. Rezultatet e provimit hidhen në proceverbale brenda 8 ditëve (check shenimet) kalendarike nga data e kryerjes së provimit, sipas verifikimeve që GVJ bëri në sekretarinë mësimore.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve. Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore. Provimet me shkrim të studentëve ruhen nga pedagogu i modulit për një periudhë gjashtë mujore pas përfundimit të sezonit të provimeve.





<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zvellimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 24 oreve. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentin është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të Departamentit, që studentin të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studentin thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.</p> <p>GVJ konstatoi se kurrikula e rishikuar përmban lëndë të formimit bazë që nuk lidhen me fushën Financë Bankë. <i>Sugjerohet të rishikohet kurrikula në funksion të fushës përkatëse Bankë-Financë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të</p>	<p>Modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse, sipas ligjit. Nuk përfshihen lëndë në gjuhë të huaj.</p>




komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve	Nga vizita dhe takimi me studentët, konstatoam se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë




inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. UAMD organizon Konferenca Studentore, ku studentët kanë marrë pjesë me punime shkencore të tyre, rezultat i mështesjes së vazhdueshme që i jep personeli akademik.		
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Shpenzimet e pjesëmarrjes dhe të botimit të temave të Konferencës studentore sponsorizohen nga projektet që ka Institucioni. Gjithashtu, në UAMD organizohen edhe konkurse për projekte dhe ide inovative, dhe realizohen me mbështetje këshilluese nga stafi akademik, por këto sponsorizohen nga vetë studentët. <i>Sugjerohet të shikohet mundësia e mbështetjes financiare nga ana e institucionit.</i>		
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi në institucion na u komunikua që nuk ka pasur interes nga studentët master, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka UMAD, pasi ata janë edhe në marrëdhënie pune.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyshet plotësisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
		x	

Standardi III.8


Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	UAMD ka realizuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike kryesisht dhe private, të cilat shfrytëzohen edhe për praktikën profesionale të studentëve të programeve master. Është konstatuar se institucioni nuk mund të akomodojë të gjitha kërkesat e studentëve për praktika, por nëse kërkohet nga studenti, kordinatori i programit asiston në gjetjen e praktikës më të përshtatshme.
Kriteri 2. Institucioni, në	<i>Sugjerohet të shtohet lista e bashkëpunimeve me biznese dhe</i>






<p>bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p><i>studentët të orientohen më tepër drejt praktikave që kane lidhje me aftësimin e tyre profesional, në rast se nuk punojnë.</i></p> <p>Praktika profesionale përfundon me një raport mbi eksperiencën e fituar. Mbrojtja e saj me sukses shoqërohet me fitimin e 6 krediteve ECTS.</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
		<p>X</p>		

<p>Standardi III.9 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Nga verifikimi i GVJ diplomimi studentëve në këtë program bëhet me mbrojtjen e një punimi diplome. Kriteret dhe procedurat e diplomimit përcaktohen në <i>(Rregulloren e Programit neni 27)</i> dhe Fakultetit (neni 66) Detajet jepen në Evidencen 124 Rregullore për tezat master.</p> <p><i>Sugjerohet që punimet e diplomave master të publikohen në faqen e internetit të UAMD.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Strukture përgjegjëse e këtij programi është Departamenti Kontabilitet - Financë, i cili sipas rregullores dhe atyre që konstatuam i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit. Për këtë angazhohej stafi akademik. Sipas kriterëve studenti depoziton kërkesën pranë departamentit për tu listuar në listën e studentëve për mbrojtje diplome. Në kërkesë ai parashtron temën e diplomës brenda fushës së studimit dhe propozon pedagogun udheheqës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, mbi bazën e të cilave harton</p>




	listën e studentëve që plotësojnë kriteret për të përgatitur një punim diplome dhe udhëheqësin dhe ja paraqet për miratim Dekanit të Fakultetit. Drejtuesit e temave të diplomës për të gjithë studentët e listuar që plotësojnë kriteret, miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Formati i paraqitjes së punimit të diplomës është përcaktuar në rregulloren e departamentit.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Referuar rregullores së Institucionit, të Njesisë Kryesore, si dhe rregullores së Diplomimit, cikli i dytë i studimeve Master Profesional përmbyllet vetëm me mbrojtjen e mikrotezës. Mbrojtja e mikrotezës bëhet para një komisioni të propozuar nga njësia bazë dhe të miratuar nga njësia kryesore.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Nga takimet me studentet dhe stafin, GVJ konstatoi që udhëheqësi i punimit të diplomës orienton dhe ndihmon studentin për përgatitjen e temës së diplomës. Se bashku përgatisin programin e punës së studentit, afatet gjatë të cilave ndihmohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ vlerësoi nga takimet se studentët e programit të studimit, e përdorin shumë pak bibliotekën e institucionit. Laboratorët e teknologjisë së informacionit kanë mjedise të mjaftueshme dhe kompjutera të cilat studentët e këtij program studimi, mund t'i përdorin për përgatitjen e temave të diplomave.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Nga verifikimet dhe vizita ne institucion u konstatua se pedagogu udhëheqës i temës përgatit metodikën e studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë studentin, duke i dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë e tij. Gjithashtu, udhëheqësi në përfundim të punimit harton një raport të shkurtër me anë të të cilit e miraton atë, ose në rastet kur studentin nuk i është përmbajtur kriterëve dhe udhëzimeve të tij nuk e miraton, ose i ben vërejtjet për përmirësim. Këtë raport ai ja paraqet komisionin së bashku me punimin e temës së diplomës. (Ref. Rregullore e UAMD; Rregullore Fakultetit të Biznesit; Rregullore departamentit KONTabilitet – Finance ; Rregullore e Programit, Rregullore per tezat master)
Kriteri 7. Në përfundim të	Studentët vlerësohen me notë për mbrojtjen e diplomës dhe





provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	kjo pasqyrohej në procesverbalet e depozituara në sekretarinë mësimore.		
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Siç është e parashikuar në nenin 90 të rregullores së UAMD-së, në përfundim të studimeve në Programin Master Profesional, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës.		
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studentit, me kërkesë të tij, i vihet në dispozicion kopje e plote zyrtare e programit të studimit nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, sektori i çështjeve mësimore.		
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Dokumentacioni për studentët ruhet për një kohë të pacaktuar nga institucioni si në hard-copy edhe në databazën digjitale që disponon UAMD. GVJ konstatoi që dokumentacioni për studentët ne vite është i plotë por ka student të vitit të kaluar ende të pamatrikuluar. Sekretaria na vuri në dispozicion kërkesën që ka bërë për matriculimin e studentëve.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të	UAMD ka krijuar të vecantë Zyrën e Burimeve Njerëzore e cila mbledh, rauna dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Nga intervistimi i personelit të Zyrës së Burimeve Njerëzore, por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është





<p>dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë. Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcaktonte Departamenti përkatës, në vijim priteshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim. Zyra e personelit ishte pjesë e të gjitha hallkave të procesit dsuke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>UAMD në përputhje me <i>nenin 45 dhe 46</i> të statutit ka të përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Rregulloren e programit dhe atë të Fakultetit.</p> <p>Departamenti bën planifikimin për staf akademik bazuar në numrin e studentëve të planifikuar, dhe pasi miratohen nga Fakulteti publikohen në faqen e internetit të institucionit dhe mediat audiovizive e të shkruara. Cdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision, i cili përbëhet nga drejtues të Rektoratit, fakultetit, departamentit dhe titullarit të lëndës që do japë mësim.</p> <p><i>(Aneksi 110 Procedura e Rekrutimit te stafit)</i></p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat e rekrutimit të personelit. Departamenti përcakton kriteret specifike dhe të përgjithshme për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik. Shpallja e pozicioneve bëhet publike në faqen e institucionit. Aplikimet kalojnë një sistem pikëzimi ku 70% zë përmbushja e dokumentacionit dhe 30% intervista.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga përzgjedhja e dosjeve të stafit të programit gjatë vizitës në institucion, rezultoi se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore gjendet dokumentacioni si, kontrat e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV etj.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përbushet Përbushet Përbushet</p>





standardit			kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Infrastruktura e UAMD krijon kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. UAMD ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturore për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Por nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, <i>GVJ iu referua se pika të dobëta në department mbeten logjistika IT e programet kompjuterike.</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Institucioni përdor kryesisht mobilitetet për kualifikimin e mëtejshëm të stafit, por përpos kësaj konfirmuar edhe nga intervista me stafin <i>nuk është organizuar ndonjë trajnim specifik apo të parashikohet një organizim i një programi të caktuar në lidhje me kualifikimin e stafit në shkrim projektesh psh apo në avancimin e metodikave të mësimdhënies.</i>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni ka angazhuar staf akademik kryesisht të jashtëm për të plotësuar kërkesat e programit; kriteri 70% e personelit të jetë staf i brendshëm nuk plotësohet. Kjo është e konfirmuar edhe nga shefja e Departamentit. Për sa i përket angazhimit optimal, nga evidencat e dorëzuara pas vizitës, përfshihet angazhimi i stafit vetëm në programin MP, jo në të




	gjithë programet e Fakultetit. Për rrjedhojë GVJ nuk është në gjendje të përcaktojë nëse stafi ka mbingarkesë dhe nëse kryhet një ndarje optimale e ngarkesës në burimet njerëzore të disponueshme.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në sistemin AMS për infrastrukturën e UAMD, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare. Sallat e leksioneve mbeten ende për t'u pajisur me kompjutera e projektorë. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Burimet Njerëzore, Financa, Biblioteka, etj janë të akomoduar në ambjentet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. Institucioni ofron gjithashtu ambjente shlodhëse si bar/kafe të cilat janë në dispozicion të stafit dhe studentëve.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambjentet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambjente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me kompjutera e projektorë. Kampusi universitar i UAMD ku ndodhet Fakulteti I Biznesit, duke qenë një ndërtim i ri me standarte bashkëkohore teknike, ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", sipas të cilit kërkohen 2.5 m ² / student.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të	Financa 5 është program i cili përdoret në laborator në funksion të programit MP Bankë-Financë.




moduleve, aftësimet teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Mjediset ku zhvillohet procesi mësimor përmbajnë të gjitha aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe objektivave formuese të programit të studimit.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin. Gjithsesi sipas konstatimeve tona nuk ka patur ndonjë shembull aktiviteti të këtij lloji.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmblotshet plotësisht	Përmblotshet kryesisht	Përmblotshet pjesërisht	Përmblotshet jo
		X		

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar vizitës në institucion u konstatua se në dispozicion të studentëve ekzistojnë tre biblioteka, një në mjediset e godinës në Currila dhe dy në godinat A dhe B të kampusit në Spitallë. Në mjediset e këtyre bibliotekave studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studjuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Orari dhe shërbimi i ofruar është në funksion të nevojave të studentëve. Mjediset e bibliotekave janë të hapura edhe në fundjavë.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e	Biblioteka ishte përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike në shqip dhe anglisht, edhe pse nga kontrolli rastësor për një literaturë të detyrueshme në gjuhë të huaj mungonte teksti.




<p>mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ishte e lidhur me sistemin e RASH per libra online. Studentët e masterit profesional Bankë Financë mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës në godinën A, e cila ofron 126 vende pune e pajisur me kompjutera dhe akses në internet. Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë.</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni nuk ka krijuar akses të vecantë në një bibliotekë online të një botuesi specifik për studentet, por biblioteka bën pjesë në projektin RASH.</p>		
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Ekziston një program kompjuterik i përdorur nga biblioteka për gjetjen e titujve të librave. Po ashtu kompjuterat e gjetur në bibliotekë mund të shfrytëzohen nga studentët pa kufizime. Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik me standard ndëkombëtar, ka akses pa limit në EBSCO për të gjithë.</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Prokurimi i titujve në bibliotekë kryhet në kuader të buxhetit të institucionit, pas sugjerimeve të përcaktuara nga dekanet e fakulteteve. Cdo vit kalendarik, biblioteka në bashkëpunim me njësitë kryesore, dorëzon pranë drejtorisë së menaxhimit financiar kërkesat për blerje librash dhe pajisje të tjera. Nevojitet të rishikohen mangësitë për të alokuar fondet e nevojshme dhe për t'i mbuluar ato.</p>		
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Ky kriter plotësohet, pasi biblioteka i vihet në dispozicion studenteve edhe gjatë fundjavave. GVJ konstaton se orari i bibliotekës, është në përputhje me orarin e zhvillimit të programit të studimit. Orari i saj është i deklaruar nga ora 8.00 – 18.00, dhe është nga e hëna në të premte, ndërsa ditën e shtunë punon me orar 8.00-12.00. Në ndihmë të studentëve është edhe sektori elektronik, i aksesueshëm gjatë gjithë javës me orar të plotë.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi IV.5



Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sërë procedurash të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin, <i>por nuk disponon një system kompjuterik menaxhimi dhe administrimi të informacionit të studentit nga krijimi i kartelës dhe rregjistrimi i parë deri në diplomim të tij.</i> Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajiset me numër matrikullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e shtetit shqiptar dhe të UAMD-së në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p><u>Nuk aplikohet një sistem menaxhimi i mirëfilltë me aksesin në informacionin e nevojshëm.</u></p> <p>Referuar edhe RVB-së, cdo informacion është i aksesueshëm përmes sekretarisë mësimore dhe përmes zyrës së Alumnit. Në shumë raste informuese sekretaria është zëvendësuar nëpërmjet aksesit të informacionit te faqja zyrtare e universitetit, përmes rrjeteve sociale në të cilat publikohen të gjitha informacionet që studentët të kenë mundësi të aksesojnë informacion edhe në distancë. Zyra e burimeve njerëzore administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto të dhëna ruhen kryesisht në formë manuale.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe administrativ, në Departamentin e Kontabilitet - Financë,, bëhet nga përgjegjësi i departamentit dhe drejtuesit e grupeve mësimore dhe kërkimore. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në fakultet. Gjithashtu sistemi i hedhjes së vlerësimit monitoron në kohë reale ndërhyrjet në sistem. Ky informacion vlerësohet dhe raportohet në organet drejtuese.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë</p>	

reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.				
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Nga konstatimi i GVJ faqja e internetit të institucionit e përfshin informacionin lidhur me programin dhe stafin dhe njoftime të ndryshme. Përveç kësaj UAMD është shumë aktive edhe në rrjetet sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.6


Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ referuar GVB dhe (<i>evidencës 145</i>) konstaton se UAMD harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në UAMD, i cili përlllogarit koston e mbulimit të një cikli të plotë studimi, për çdo student në të gjitha ciklet e studimeve në institucion.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore dhe shërbim të realizimit të programit. shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesit në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion	Sipas së njëjtës evidencë në planin financiar përfshihen: (a) të ardhura: tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, shërbime të ndryshme IAL, burime të tjera, ku përqindjen më të madhe e zënë dy kategoritë e para; (b) shpenzime: nga granti i buxhetit të shtetit dhe nga të ardhurat e veta. Të gjitha kategoritë e kriterit janë të përfshira në këtë plan.




realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.				
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<p>Institucioni ka kryer audite të brendshëm të përvitshëm (<i>evidencat 77, 78, 79</i>); në to evidentohen parregullsi, por nuk ka një raport të mirëfilltë të rregullimit të parregullsive.</p> <p>Raporti financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Referuar RVB-së, në mbyllje të cdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posacme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale.</p> <p>Ne dokumentacionin e vënë në dispozicion, përveç raporteve financiare, nuk u verejt ndonjë dokumentacion që tregon ecurinë në vazhdim të programit lidhur me fiannciamin e tij.</p>			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	





V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Rregullorja e institucionit, rregullorja e Fakultetit të Biznesit, rregullorja e Departamentit të Kontabilitet – Financë dhe Rregullorja e programit të studimit (neni 22) në UAMD, janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rregullorja e Fakultetit të Biznesit (neni 47), rregullorja e Departamentit të Kontabilitet - Financë (neni 11, pika s) specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion, shqyrtimi i dokumentacionit dhe sidomos intervistat me studentët e programit, se politikat dhe procedurat e ndjekura nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejtat e tyre. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UAMD.</p> <p>(Evidenca 6-7, 11)</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e UAMD, të Fakultetit të Biznesit, të Departamentit të Kontabilitet - Financë dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi ka patur edhe largime edhe transferime studentësh. Nga takimi me Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës u konfirmua që institucioni përdor ditët e karrierës për të bërë publike procedurat dhe kriteret e pranimit. Politikat dhe procedurat bëhen publike përmes faqes së internetit sipas RVB dhe vizitave në institucion. Por nga një verifikim, nuk kishte asnjë informacion në këtë faqe.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>Referuar vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion (Evidenca 98), GVJ konstaton se UAMD miraton</p>




akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	në fillim të vitit akademik kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret përkatëse.		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Përpara cdo fillimi viti akademik, sipas informacionit që GVJ mblodhi gjatë vizitës në institucion, UAMD njeh palët e interesuara me programin e studimit që ofron dhe kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për cdo program. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet ditëve të karrierës dhe vizitave në gjimnaze.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin përcaktohen në rregulloret e universitetit, Fakultetit të Biznesit, Departamentit të Kontabilitet-Finances dhe rregulloren e programit të studimit. Nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, rregulloret u vihen në dispozicion studentëve dhe u bëhen të njohura edhe nga takimet që kanë studentët me përgjegjësën e departamentit i cili shërben edhe si koordinator i programit, (Neni 56 i rregullores së re UAMD), përcakton kriteret e transferimit të studimeve.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Rregullorja e programit të studimit MP në Bankë - Financë (Kreu V, neni 22), dhe (Neni 56 i rregullores së UAMD), përcaktojnë procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, si dhe lejon transferimin e studentëve të UAMD në shkolla të tjera. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hock i Ekuivalentimit. Studentëve u vihet në dispozicion rregullorja, nëpërmjet të cilës ata njihen me kriteret e transferimeve.
Kriteri 3. Institucioni	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të




informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	studentëve janë të përcaktuar në rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, si edhe në programet e cdo lëndë. Meqënëse programi u bëhet i ditur studentëve që orën e parë të mësimi, ata njihen edhe me mënyrën e vlerësimit të tyre në cdo lëndë.						
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit përcaktohen në rregulloren e universitetit, rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Departamentit të Kontabilitet-Financë, dhe janë të detajuara në atë të programit përkatës të studimit. Institucioni ka hartuar edhe një udhëzues mbi punimin e diplomës që u bëhet i njohur studentëve nga takimet me përgjegjësin e departamentit dhe koordinatorin e programit, dhe pedagogët udhëheqës të tyre.						
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Në fillim të cdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky institucion. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme. Gjithashtu UAMD është shumë aktiv në rrjetet sociale, përgatit fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij.						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përfunduar</th> <th>Përfundohet kryesisht</th> <th>Përfundohet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përfunduar	Përfundohet kryesisht	Përfundohet plotësisht			X
Përfunduar	Përfundohet kryesisht	Përfundohet plotësisht					
		X					

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve bëhet në mënyrë të ndryshme, i cili fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e universitetit si edhe një informacion i përgjithshëm shfaqen në faqen e internetit të UAMD, ku kurrikula ngelet për tu përditësuar.
Kriteri 2. Institucioni vë në	Gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që studentët që




dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	ditën e parë njihen me rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit dhe në orën e parë të mësimit u bëhet i njohur programi i lëndës. Një pjesë e këtij informacioni afishohet edhe në ambjentet e institucionit. Sipas intervistave në institucion dhe RVB-së, në ëeb - faqen e UAMD publikohen planet mësimore; edhe nga verifikimi i kryer, informacioni që ofrohet në faqen e internetit është i pranueshëm dhe kurrikula e disponueshme.		
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Gjithashtu kjo zyrë mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione publike dhe biznese.		
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Orari mësimor, plani mësimor afishohen në ambjentet e Fakultetit të Biznesit, dhe studentët informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e universitetit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si-klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Studentët e këtij programi e ndjekin mësimin gjatë fundjavës, një mundësi kjo për të ndihmuar studentët e punësuar.		
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	UAMD punon fort me komunikimin online në rrjetet sociale për të mbajtur studentët e informuar mbi programet e studimit dhe aktivitetet në universitet. Gjithashtu, gjatë intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se cdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të**



hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Për programin e studimit sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Biznesit në UAMD.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave përkatës mban informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit për cdo vit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ mësoi se studentet që duan ta frekuentojnë një lende pas riorganizmit të programit, bëjnë një kerkese në Dekanat dhe me pas merret një vendim nga Dekanati.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Evidenca 27_Të dhëna statistikore për studentët MP_B-F.pdf</i>), dhe vizitës në sekretarinë mësimore, numri i studentëve për tre vitet akademike rezultoi si më poshtë poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 53 studentë;</p> <p>Për vitin akademik 2018-2019 33 studentë;</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 18 studentë;</p>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	<p>Sekretaria mësimore regjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi regjistrat themelor ku çdo student është regjistruar dhe ishte pajisur me numër matrikullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar.</p> <p>Dosja e studentëve ishte e pajisur me dokumentat si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kontrata; - deklarata e studentit; - dokumenti i identifikimit; - diploma e shkollës së mesme; - diploma e studimeve të ciklit të parë;





	- dhe lista e notave;								
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ mësoi se ka një listë që mbahet në momentin që pedagogu terheq regjistrin. Po ashtu UMAD përdor një database elektronike excel me të dhënat e studentëve. Studentet që nuk e frekuentojnë i shenohet 0 pikë dhe jo mungese në procesverbalet e provimeve. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregulloren e sekretarisë mësimore.								
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Në fund të çdo viti akademik, institucioni bën një analizë mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje të studentëve. Për diplomimet në vitet e mëparshme disponohen të dhëna të plota sipër notat mesatare në hyrje dhe dalje si dhe punësimin e tyre.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbyhet plotësisht</th> <th>Përmbyhet kryesisht</th> <th>Përmbyhet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht				X
	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nëpërmjet Statutit të UAMD (neni 88-90) institucioni parashikon angazhimin dhe vendimmarrjen e studentëve në aktivitete kërkimore dhe kulturore, ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese të FB (neni 84, pika b).
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion, GVJ konfirmoi se studentët ishin të përfshirë në





<p>përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>vlerësimin mbi procesin akademik (pjesë e GVB), por nga biseda me grupin e studentëve u kuptua që ata këshillohen me stafin akademik dhe shefin e departamentit por nuk përdorin zyrat mbështetëse për këtë qëllim. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin studentor. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre si në këshillin e etikës (<i>neni 22 i Statutit të Ri UMAB</i>) por nuk ka përfaqësues të studentëve në zyrën e NJBSC.</p>		
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve. Statuti i UAMD dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendim marrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtëpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetsori që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri (<i>Evidenca Nr. 84</i>).</p>		
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Statuti i UAMD (<i>neni 89</i>) Rregullorja e Fakultetit (<i>neni 59 dhe 62</i>), dhe rregullorja e programit të studimit MP në Bankë-Financë (<i>neni 37 pika c dhe f</i>), mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqen nga institucioni në këtë rast.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.6

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për prítjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Statuti dhe rregulloret e institucionit përcaktojnë procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Zyra e Komunikimit, Alumni dhe Karrierës në UAMD kryen disa funksione, përfshirë edhe atë të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve. Kjo zyrë është e re por shumë aktive në komunikimin përmes rrjeteve sociale. Gjate vizitës GVJ konstatoi se studentët nuk kanë shumë dijeni dhe nuk e shfrytëzojnë këtë zyrë.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimarrëse (<i>Statuti UAMD, neni 89</i>), këshilluese dhe të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies, studentët kanë mundësi që të asistojnë në çështje që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Të drejtat e studentëve në këtë drejtim, duhet të përcaktohen edhe në Rregulloren e Zyrës së Komunikimit, Alumni dhe Karrierës në UAMD.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Referuar (<i>Evidencës 174 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës</i>) janë të përcaktuara qëllimi dhe aspektet e komunikimit në UAMD për ti shërbeyer nevojave për zhvillim të karrierës së studentëve, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbime të ndryshme nëpërmjet këshillimit, konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, që nga organizimi i përvitshëm i prezantimit të programeve të studimeve në ambjentet e Fakulteteve, informin e studentëve, lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, dhe mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të	Sipas (<i>Evidencës 174 Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës</i>), një nga detyrat e kësaj zyrë është edhe perpilimi, plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të punësimit për studentët e diplomuar. Nga vizita në institucion, GVJ-së iu konfirmua se kjo zyrë publikon herë pas here njoftime për





studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	mundësi punësimi, duke ia dërguar edhe grupeve të studentëve të diplomuar sipas profileve të tyre të studimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UAMD ka ngritur struktura te tilla si NJSBC Qendrore e cila quhet “Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë”, që nga muaji Maj 2019, dhe NJSBC pranë cdo Fakulteti të cilat kanë hartuar procedura për të siguruar cilësinë e programeve (<i>neni 81 i rregullores në UAMD</i>). Gjatë vizitave në institucion GVJ-së iu referua që kjo njesi ka 8 anëtarë në përberjen e saj por në takim u paraqit vetëm kryetari i saj. GVJ <i>konstatoi pas diskutimeve, se kjo njësi e ka të vështirë të monitorojë të gjitha programet e ofruara nga UAMD</i> . Për këtë arsye dhe si pasojë e nevojave imediate të institucionit për akreditimin e disa programeve studimore njëkohësisht, është ngritur NJSBC pranë Fakulteteve përkatëse ku anëtarë janë shefat e cdo departamenti dhe 2 zv/dekanet. Kjo strukturë e dytë mund ti shërbejë si ndihmë njësisë kryesore por, mendojmë që krijojnë konflikt interesi në vetvete si edhe mbi-vendosje detyrash për shefat e departamenteve. (<i>Ref. Kreu VII i Statutit të ri</i>) Në përfundim, GVJ mendon se NJSBC pranë UAMD nuk funksionon plotësisht. Si rrjedhim, Rekomandojmë që NJSBC





	<p>Qendrore të shikojë mundësinë e shtimit të stafit të saj për të përballuar ngarkesën si edhe ushtruar veprimtarinë e saj më aktivisht dhe e PAVARUR për të garantuar edhe transparencën. Kjo gjithashtu e rëndësishme edhe për <u>përmbushjen (brenda vitit 2017-2018) e rekomandimit Nr.1 të lën nga grupi i vlerësimit mbi akreditimin insittucional.</u></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UMAD ka ngritur një sërë mekanizmash në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave ku sipas vizitave në institucion janë bërë disa takime me biznese, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të profesorëve ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</p> <p>Sistemi operativ i sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse (<i>Kreu VI mbi Sigurimin e Cilësisë dhe Akreditimin, i Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve</i>). Kjo rregullore përshkruan elementët e syllabusit dhe pyetësorin e studentëve, por nuk detajon procedurat, udhëzimet dhe format e përdorimit dhe standartet për sigurimin e cilësisë në institucion dhe programin e studimit.</p> <p>Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet (<i>evidenca 85</i>). Në këtë Njësi përfshihen personel i brendshëm i Universitetit; por nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, cka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, sic e pasqyron organograma.</p> <p><i>Sugjerohet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Të detajohet manuali i sigurimit të cilësisë; - Të ketë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi;
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që</p>	<p>UAMD bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të NJSBC-së, siç u përmend edhe më lart. Gjatë vizitave në institucion na u përmendën përpjekjet që stafi akademik ka bërë për të krahasuar kurrikulën ekzistuese dhe përmirësimin e saj me kurrikula të programeve të ngjajshme në vendet e BE-së.</p> <p>Institucioni ka kaluar me sukses vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional dhe është në proces për akreditimin e disa programeve të studimit.</p>





<p>promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>UAMD nuk pasqyron në raportin vjetor të cilësisë masat e ndërmara në lidhje me raportet e ekspertëve të jashtëm dhe rekomandimet e tyre. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti i angazhimit i po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</p> <p>NJSBC duke qenë se është krijuar së fundmi nuk ka një analizë në lidhje me instrumentat e sigurimit të cilësisë të përdorura gjatë vitit korent akademik, si psh rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e profesorëve, konkluzionet e nxjerra dhe plan aksioni per t'i vendosur në funksion.</p> <p><i>Sugjerohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë, rishikimi i instrumentave për të garantuar përdorshmërinë e tyre dhe përfshirja e përdorimit të instrumentave në analizën vjetore të NJSBC.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion vumë re se përfaqësuesi i zyrës së Kurrikulës dhe Cilësisë ishte mjaft i angazhuar për të dhënë kontributin e tij në kuadër të NJSBC-së gjë e cila tregon për formimin e një kulture institucionale të orientuar drejt cilësisë. UAMD ndjek procedura periodike si rishikimi i syllabuseve apo kurrikula e programeve e rishikuar (<i>Evidenca 91 per riorganizimin e kurrikulave</i>), kjo edhe në kuadër të përmushjes së detyrimit ligjor për përshtatjen me ligjin e ri të arsimit, por edhe si pasojë e politikës institucionale, por NJSBC nuk merr pjesë si hallkë e pavarur në këtë proces pasi përfshin në mekanizmat e vet Komisionin e ngritur në rang Fakulteti. Përveç përdorimit të mekanizmave të mësipërme, sigurimi i cilësisë shtrihet edhe në rekrutimin e stafit, organizimin e programit mësimor, zhvillimin e programit dhe kërkimin. NJSBC në cdo rast është prezent për të siguruar cilësinë dhe për të krijuar një kulturë në rang institucional. Ajo që nevojitet të shënohet është fakti në angazhimin e po të njëjtit staf që vendos detyra, i plotëson dhe i monitoron, duke mos patur pavarësi nga njëra-tjetra.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmushet</p>	<p>Përmushet</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave





formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Njësia bazë për menaxhimin e programit të studimit është Departamenti. Kjo njësi bazë së bashku me NJSBC e ngritur pranë Fakultetit të Biznesit (<i>Evidenca nr. 6 Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i>), kryen mbikëqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve. Sic përmendet edhe tek Raporti vjetor NJSBC, kjo Njësi ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të saj. Ndërkohë mbetet për tu konsoliduar NJSBC e ngritur pranë Fakultetit të Biznesit e cila është ende në hapat e para të organizimit të saj, nëse kjo njësi do të vazhdojë funksionin e saj edhe përtej procesit të akreditimit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Fakulteti i Biznesit me Departamentet përbërëse si dhe në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë krijojnë komisione adhoc për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë (<i>evidenca 85</i>).
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm: <ol style="list-style-type: none"> 1. Anketimi i studentëve me anë të një pyetësoi; 2. Mbledhjet departamentale por edhe në rang fakulteti; 3. Vlerësimi i pedagogut në orën mësimore; Përdorimi i mekanizmave është relativisht i ri, prandaj ngelet për t'u vlerësuar efikasiteti i mirëfunksionimit të tyre.
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, edhe pse janë përmendur në Raportin vjetor të NJSBC, nuk ka një analizë të mirëfilltë të tyre për të kuptuar çfarë është vlerësuar dhe si ka qenë ecuria e vlerësimit, nëse janë marë masa apo ka ndonjë plan aksioni për to. Në fakt ato analizohen dhe përfshihen në Raportet vjetore të Departamentit. <p><i>Sugjerohet që rezultatet e mekanizmave të vlerësimit dhe të sigurimit të përfshihen në një proces vetvlerësimi të stafit akademik. Po ashtu të integrohen raportet vjetore departamentale në atë të NJSBC-së.</i></p>
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit	Në raportet vjetore të Departamentit dhe në raportin e




duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	NJSBC duhet të përfshihet një analizë e detajuar e matësve sasior dhe të adresohen mangësitë e ndryshme për përmbushje.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		x	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Departamenti Kontabilitet - Financë i cili është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, bën vlerësime periodike të brendshme për programin e studimit dhe i pasqyron në raportin vjetor të analizës mësimore në nivel departamenti. Gjithashtu, departamenti realizon në mënyrë periodike analizë të punës mësimore, ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës në departament, por edhe në nivele të tjera më të larta në qoftë se është e nevojshme. Ky vit është viti i parë i akreditimit të programit të studimit dhe UAMD ka përfshirë keto analiza për vetëvlerësim të brendshëm dhe vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit. (evidence 38)
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Komisioni i Sigurimit të cilësisë në UAMD ka një mandat 2 vjeçar dhe në përbërjen e tij ka një anëtar nga cdo Fakulteti, për të mundësuar përputhshmërinë me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit objekt vlerësimi.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor	Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti Kontabilitet - Financë, për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës,




<p>metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>të mësuarit; intervista të drejtpërdrejta; dëgjime në auditor; testimet paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Në UAMD përvec NJSBC, departamentit Kontabilitet – Financës, si njësi bazë e ofrimit të programit të studimit, angazhohen edhe zyrat e tjera të institucionit, si ajo e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe zyra e Këshillimit të Karrierës.</p> <p><i>Rekomandohet të integrohen gjetjet e zyrave mbështetëse në raportet dhe analizat vjetore departamentale dhe të fakultetit për të garantuar procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore dhe objektivat e programit të studimit.</i></p>						
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Si pjesë e rëndësishme e filozofisë së UAMD por edhe në Manualin e Cilësisë, shprehet që studentët inkurajohen të jenë pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të UAMD këshillave studentore, Komisionit të Etikes, etj, por në praktike, u vu re se nuk ka përfaqësues të studentëve të cilët të jenë pjesë e sigurimit të cilësisë së programit.</p> <p><i>Sugjerohet të këtë përfshirje të stafit të pavarur dhe studentëve për të kryer funksionet e sigurimit të cilësisë me integritet dhe pavarësi.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="609 1518 794 1621">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="794 1518 999 1621">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="999 1518 1203 1621">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="609 1621 794 1668"></td> <td data-bbox="794 1621 999 1668" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="999 1621 1203 1668"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

<p>Standardi VI.4</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të</p>	<p>UAMD harton standardet për sigurimin e cilësisë të</p>




<p>parashikojë dhe garantojnë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>institucionit në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Institucioni ka shpërndarë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, rektorat) të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të saj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja e NJSBC-së përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>NJSBC prane Fakulteteve përkatëse përbëhet nga shefat e cdo departamenti dhe 2 zv/dekanet dhe nuk ka asnjë përfaqësues të studentëve dhe as raporti vjetor i NJSBC Qendrore nuk është firmosur prej ndonjë përfaqësuesi studentësh.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademiq e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Kontabilitet - Financës është njësi bazë përgjegjëse për cilësinë e programit. Disa nga anëtarët e departamentit janë pjesë e komisioneve të tilla si Komisionet për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Rregullorja e insitucionit, Rregullorja e Fakultetit të Biznesit dhe Rregullorja e NJSBC, parashikojnë angazhimin e anëtarëve te personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit në mënyrë të barabartë.</p> <p>Nga vizitat në institucion shihet e nevojshme të rekomandohet që studentët të informohen dhe përfshihen në implementimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të</p>	<p>UAMD ka realizuar takime me biznese dhe ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Por gjatë takimeve në institucion nuk qe e mundur</p>




vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	të takoheshin përfaqesues të biznesit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Institucioni zhvillon një pyetësor me studentët për vlerësimin e moduleve dhe profesorëve në fund të cdo semestri. Rezultatet e pyetësorëve i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit si edhe vetë profesorit. Ato diskutohen në mbledhjet departamentale dhe merren masat e nevojshme në rast problematikash.</p> <p>Por në NJSBC përfshihen personel i brendshëm i Universitetit, nuk ka anëtarë të jashtëm të pavarur dhe as përfaqësues të studentëve. Po ashtu anëtarët e saj janë mbajtës të disa funksioneve të tjera pedagogjike apo administrative, cka e vë në diskutim funksionin e saj të pavarur, sic e pasqyron organograma.</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>NJSBC harton një plan vjetor të përvitshëm, ku parashikon te gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Me pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Gjithashtu NJSBC informon në mënyrë periodike rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin akademik rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p><i>Rekomandohet që raporti të shpallet publikisht në ëeb faqen e universitetit.</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e	<p>Pas rezultateve të vlerësimit, NJSBC-ja harton një raport i cili përcillet tek njësitë bazë dhe kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre, duke dhënë sugjerime për përmirësimin e veprimtarisë. Propozime të NJSBC</p>




dobësive të evidentuara.	shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit për tu reflektuar në vendimmarrje konkrete.		
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC harton raporte vjetore vlerësimit të Brendshëm ku pasqyrojnë rezultatet e vazhdueshme të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të institucionit. Këto raporte dërgohen në MASR. Gjithashtu diskutohen në Rektorat dhe Bordin e Administrimit, u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.		
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	UAMD i kushton rëndësi trajnimit të stafit për përmirësimin njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies. UAMD organizon leksione të hapura me studentët, merr mendimin e studentëve, nëpërmjet këshillit studentor, mbi çdo program studimor në tërësi, apo për çdo lëndë e pedagog të veçantë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirëset plotësisht	Përmirëset kryesisht	Përmirëset plotësisht
		X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmirëset plotësisht	Përmirëset kryesisht	Përmirëset plotësisht
		X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “Bankë - Financë.”

a. Pikat e forta dhe afirmime:


1. Programi është në përputhje me misionin, qëllimin, strategjinë e zhvillimit dhe aktet rregullatore të IAL, dhe synon në ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. Ai është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënlige në fuqi;
2. Programi i studimit, nëpërmjet objektivave të vendosura, synon të plotësojë nevojat e tregut të punës.
3. Fusha e studimit Bankë-Financë ngelet e preferuar në tregun lokal;
4. Personeli akademik që mbulon mësimdhënien në këtë program studimi është i kualifikuar, i dedikuar dhe i ri me energji dhe dinamizëm në përmbushje të objektivave të programit të studimit.




5. Institucioni ofron ambiente cilësore për zhvillimin normal të programit të studimit dhe kapacitetet e Fakultetit janë të mjaftueshme për të përballuar rritjen e numrit të studentëve;

b. Pika të dobta:

1. Mungesë e një studimi të tregut për analizimin e të dhënave të punësimit në nivelin e duhur për të përmirësuar programin në aspektin e objektivave dhe të mundësive të punësimit që ai ofron;
2. Numri i studentëve të regjistruar në rënie krahasuar me fillimet e programit;
3. Kurrikula e drejtuar nga teoria dhe jo nga praktika; specififikisht:
 - a) Programi i studimit, edhe pse është i nivelit master profesional, nuk i është larguar formës klasike që është pothuaj i ngjashëm me nivelin bachelor. Programi ka më shumë karakter teorik dhe të thelluar se sa praktik dhe profesional. Studentët janë të varur nga kërkesat dhe detyrimet dhe nuk nxiten shumë për punë të pavarur;
 - b) Përfshirja në program e një numri të konsiderueshëm lëndësh të avancuara, i japin programit më shumë pamjen e një programi studimi Master Shkencor se sa profesional;
 - c) Në disa lëndë mund të përfshihen më shumë forma profesionale të ngjashme me ato të materializuara në praktikën profesionale. GVJ gjykon se ky program ka mangësi në lidhje me ofrimin e thelluar profesional për arsye:
 - I. Përseritje të koncepteve bazë në disa module;
 - II. Mangësi në lidhje me kombinimin praktikë teori;
 - III. Përfshirje të lëndëve jo të fushës “Bankë-Financë”;
4. Marëdhënie të dobta me biznesin si në kuadër të evidentimit të nevojave të tyre edhe në kuadër të bashkëpunimit për praktika profesionale, trajnim të mëtijshëm dhe përditësim të programeve në funksion të tyre;
5. Struktura ndihmës akademike të ngritura por jo funksionale në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, shërbimeve dhe informimit të studentëve. Specifikisht:
 - a. NJSBC funksionon në rang Institucioni dhe Fakulteti, por roli i saj akoma nuk ka filluar të evidentohet për të rritur cilësinë e programit dhe të stafit akademik. Ka mungesë personeli dhe pavarësie në funksionet e saj të ndërmara deri tani.
 - b. Rrjetizimi i universitetit duke përdorur stafin aktual akademik dhe studentët e diplomuar duket se nuk është në nivelet e duhur, pasi është shumë ulët pjesëmarrja në programet e shkëmbimit nga pedagogë dhe studentë dhe po ashtu i ulët numri i studentëve të gjurmuar.
 - c. Pyetësorët e realizuar në bazë vjetore koordinohen me NJSBC, por përfundimet nuk ju behën të ditura dhe studentëve. Nuk është evidentuar ndonjë rast që të jetë realizuar ndryshimi apo reflektimi ndaj vrejtimeve dhe sugjerimeve studentëve lidhur me mësimdhënien
 - d. Në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së departamentit të Financë-Kontabilitetit që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembuj të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë




- shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit. Nuk rezulton të përdoren metoda të ndryshme dhe të diferencuara midis grupeve të ndryshme të studentëve.
- e. Për personelin akademik me kohe të plotë apo me kohë të pjesshme nuk janë realizuar trajnime specifike që synojnë përmirësimin e procesit të mësimdhënies apo përmirësimin e kompetencave didaktike.
6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këtë njësi, por për këtë program studimik është konfirmuar se mbulimi në masën 70% me staf të brendshëm nuk ka qënë i mundur. Po ashtu institucioni nuk ka mundur të lektorë të huaj në këtë program;
 7. Infrastruktura e përdorur për realizimin e programit ka mangësi të evidentuara si me poshtë:
 - a. Sallat e leksioneve mbeten ende për tu pajisur me kompjutera e projektorë.
 - b. Logjistika IT dhe programet kompjuterike janë pika më e dobët e infrastrukturës
 - c. Biblioteka kishte numër të kufizuar botimesh dhe kryesisht botime të vjetra. Literatura e detyrueshme në gjuhë të huaj mungonte. Studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë artikujt të ndryshëm si material mbështetëse nëpërmjet abonimit që universiteti ka bërë në EBSCO, por numri i botimeve është i kufizuar.
 - d. Laboratorët ekzistojnë, por studentët kanë specifikuar se nuk përdorin në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre.
 - e. Platformë online (e-learning) nuk aplikohet në UAMD.
 - f. Nuk ka infrastrukturë (softëare të dedikuara) për të evidentuar plagjiaturën.
 - g. Nuk ka një sistem logjistik për të krijuar lehtësi në përmbushjen e procedurave student-sekretari-pedagog për rregjistrimin, hedhjen e notave apo komunikimin; gjithçka vijon të kryhet manualisht.


Rekomandime:

1. GVJ bazuar në verifikimin e tij sa më sipër sugjeron se programi duhet riparë në aspektin e përmbushjes së objektivave të tij dhe, duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal, dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, si në Ballkan dhe BE, për të rritur konkurrueshmërinë e studentëve;
2. Rekomandohet që të riorganizohet grupi i lëndëve bazë duke përfshirë më tepër lëndë të profilit të Bankë-Financë për t'i ardhur më në ndihmë formimit profesional të studentëve në këtë fushë specifike dhe për të lehtësuar punësimin e tyre;
3. GVJ duke u bazuar në faktin se ky program i përket një masteri profesional rekomandon se Institucioni duhet të organizojë dhe instensifikojë marrëdhëniet me biznesin për të ofruar praktika edhe mundësi punësimi për studentët e programit, duke përmbushur edhe objektivat e programit;
4. GVJ sugjeron se në përmbushje të objektivit të programit për të përgatitur profesionistë të fushës Bankë-Financë që të jenë konkurrues në tregun nderkombëtar, institucioni mund të rishikojë mundësinë për të ofruar lëndë në gjuhën angleze; kjo do të ishte një mundësi përthithje e studentëve të huaj;
5. Në lidhje me NJSBC ose "Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë":
 - a) Rekomandojmë të shikojë mundësinë e shtimit të stafit të saj për të përballuar ngarkesën si edhe ushtruar veprimtarinë e saj më aktivisht dhe e PAVARUR për të




garantuar edhe transparencen. Kjo gjithashtu e rëndësishme edhe për përmbushjen (brenda vitit 2017-2018) e rekomandimit Nr.1 të lënë nga grupi i vlerësimit mbi akreditimin insituional;

- b) Rekomandojmë të detajohet manuali i sigurimit të cilësisë. Në këtë aspekt institucioni duhet të hartojë një procedurë monitorimi të gjetjeve nga pyetësorët, nje plan aksioni nga Komisionet pëkatëse dhe një monitorim i përmbushjes se planit. Duke qenë se NJSBC është strukture e re GVJ konstatoi se ne këtë aspekt ka vend për përmirësim;
 - c) Rekomandohet pavarësia e stafit në hallkat e sigurimit të cilësisë, rishikimi i instrumentave për të garantuar përdorshmërinë e tyre dhe përfshirja e përdorimit të instrumentave në analizë vjetore të NJSBC;
6. Rekomandohet që rezultatet e mekanizmave të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë të përfshihen në një proces vetëvlerësimi të stafit akademik. Po ashtu të integrohen raportet vjetore departamentale në atë të NJSBC-së;
 7. Rekomandohet të integrohen gjetjet e zyrave mbështetëse në raportet dhe analizat vjetore departamentale dhe të fakultetit për të garantuar procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore dhe objektivat e programit të studimit;
 8. Në lidhje me dosjet e personelit akademik, sugjerohet nje mbajtje me e regullt dhe me te gjithë dokumentacionin perkates të përditësuar në të njëjtin ambient, pasi universiteti kishte arkiva në dy vende;
 9. GVJ rekomandon që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj te pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
 10. Rekomandohet përdorimi i një sistemi elektronik për të rritur transparencën në vlerësim;
 11. Rekomandohet që politikat dhe procedurat të bëhen publike përmes faqes së internetit sipas RVB dhe vizitave ne institucion;
 12. Sugjerohet që fletoret e provimeve të sekretohen;
 13. Sugjerohet që punimet e diplomave master të publikohen në faqen e internetit të UAMD;
 14. Sugjerohet të shikohet mundësia e mbështetjes financiare nga ana e institucionit për shpenzimet e pjesmarrjes dhe të botimit të temave të Konferencës studentore dhe konkurseve për projekte dhe ide inovative;





Evaluation Process of the study program “Professional Master in: “ Banking and Finance”

a. Strengths and Opportunities

1. The study program is in compliance with the mission, vision, objective and development strategy as well as all regulatory acts of the Institution and preserves the maintenance of national interests and values. The study program is organized based on the legal requirements in place;
2. The objectives of the study program aim to complete the market need on the field of Banking and Finance;
3. The field of Banking-Finance is still very preferable in the local market;
4. The academic staff that supports the teaching of this study program is qualified, very dedicated and young full of energy and dynamism to fulfill the program’s objectives;
5. The institution offers an appropriate campus and has the capacities to attain an increased number of students in the future;

b. Weaknesses:

1. A market study missing to analyse the employment data at the right level that is required to meliorate the program’s objectives and the employment opportunities that it offers.
2. The reduced number of students compared with the initial years numbers;
3. A curricula more directed in theoretical prospective rather than practical. Specifically:
 - a. The study program even though a professional master is still following the classic form resembling a bachelors’ degree. The program is more theoretical than practical and the students are dependent on the demands and obligations rather than being directed towards independent work.
 - b. The inclusion of more advanced courses give to the study program a profile of a masters in science rather than professional.
 - c. In some courses more practical cases might be included that resemble the real professions. We consider a lack in the professional aspect due to repetition of basic concepts, lack of combination theory-practice, inclusion of irrelevant advanced courses with the field of study.
4. Weak relationships with the business factor in the framework of identifying their needs, offering internships and further training as well as updating the curriculars in their function;
5. Supportive structures have been created but are not in function to maintain and increase the quality of teaching, services and information of students. Specifically:
 - a. The Quality Assurance Unit is created in institutional level, yet its role has not started to be evident in the increase of quality of the program and the academic staff. There is a lack of staff and independence in their functionality.
 - b. The networking of the institution is not at the appropriate level, due to low participation of academic staff and students in mobility programs and low alumni tracking number.

- c. The student evaluations are coordinated by the Quality Assurance Unit, but the results are not published to the students. Nor it has been evident a certain change coming from student's suggestions regarding the teaching process.
 - d. In the annual report of the Department there are no cases of academic staff differentiation of teaching methods, their encouraging or best evaluated practices or other different methods of evaluation towards different groups of students.
 - e. The academic staff (part-time or full-time) has not followed any special training that enhance the quality of their teaching methods.
6. The Department fulfills the legal requirements of quality for its academic staff, but the range of 70% full-time staff engaged in the teaching process of this study program has not been fulfilled. No visiting/foreign academic staff either has been provided for this study program;
 7. The lack in infrastructure used for the program: missing logistic program, labs, restricted access in the library, missing infrastructure in the classrooms/theatres, missing e-learning platform, missing software for the identification of plagiarism, missing internal management system to facilitate the registration of courses, the grading and the communication between academics administrative offices and students. All are processed manually;

Recommendations:

- 1) Based on its verification the external evaluation group suggests that the program has to be reviewed in the aspect of fulfilling its objectives and in comparison with other similar professional programs in the local market and in geographically near with our country markets, in order to increase the students competitiveness;
- 2) We recommend the basic modules to be reorganized, including more modules of the profile Banking-Finance in order to support the professional knowledge of the students in this specific field and to facilitate their employment;
- 3) Considering this is a professional master, we recommend that the institution should organize and intensify the relationships with the business facts offering internships and job opportunities in fulfillment of the program's objectives;
- 4) In order to fulfill the objective of preparing professionals in the Banking-Finance field and to be competitive in the international market, the institution may look at the opportunity offering modules in English language; this might also be a way to attract foreign students;
- 5) Considering the Quality Assurance or "The Directory of Curriculas and Quality Assurance, we recommend the following:
 - a. To check the possibility of adding employees in order to face the load and the perform its activity better and independently so that it can guarantee transparency. This is also important for the fulfillment of institutional accreditation recommendation nr. 1.
 - b. The Quality Assurance Manual to be more detailed. There is a need of a monitoring procedure of findings from the questionnaires, an action plan from the respective Committees as well as a monitoring of its completion. Considering the the Quality Assurance Unit is very new, the experts judge that there is room for improvement.




- c. The Quality Assurance levels/stages and people should be independent. The instruments to guarantee the quality assurance should be useful and included in the annual report of the Quality Assurance Unit, besides the Department.
- 6) It is recommended that the results of the quality assurance instruments and mechanisms to be included in the self-evaluation reports of the academic staff;
 - 7) It is recommended that all the findings and activity of the support offices to be included in the yearly reports of the Department and Faculty to guarantee the educational process and its compatibility with the study program and its objectives;
 - 8) It is recommended that the updated personnel documentation to be kept safe in one building as the university had the spreaded in two locations;
 - 9) It is recommended the library to be updated both in Albanian and foreign language continuously reflecting the qualitative changes of the study program and the recent developments of literature nationally and internationally;
 - 10) It is recommended the usage of an electronic system to increase transparency in the evaluation process;
 - 11) It is recommended that policies and procedures to be published through the webpages;
 - 12) It is recommended that the exam notebooks are secreted;
 - 13) It is suggested that master thesis diplomas are published in the webpage of UAMD;
 - 14) It is suggested that the institution considers the financial support of participation fees and publishing of student conferences and other competitions of innovative projects;




Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
				Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT	I			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT	I			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE					X
VI. SIGURIMI CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE	i			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X	

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Sherif BUNDO



Dr. Andromahi KUFO





